



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



Gjendja e Sektorit të Energjisë në Shqipëri  
dhe  
Veprimtaria e ERE – s gjatë Vitit 2014

## **HYRJJE**

Gjatë vitit 2014 në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit ka pasur zhvillime të rëndësishme në lidhje me përgatitjen e ndryshimeve strukturore dhe performancën e këtij sektori. Zhvillimet me të rëndësishme gjatë këtij viti kanë ndodhur kryesisht në sektorin e energjisë elektrike.

Gjendja financiare në sistemin energjetik u karakterizua nga një performancë në rritje gjatë vitit 2013 e në mënyrë të veçantë u përmirësua gjatë vitit 2014.

Kjo performancë në rritje u reflektua në uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe përmirësim të nivelit të likuiditetit në marrëdhëniet e kompanive të rregulluara (KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.).

Ky përmirësim në funksionimin eficient të kompanive të rregulluara dhe të tregut të energjisë elektrike në tërësi, rriti sigurinë e furnizimit të vendit me energji elektrike.

Deri më 27 tetor 2014, kompania vijoi të ushtrojë aktivitetin, në administrim të përkohshëm, siç është përcaktuar në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar.

Në korrik 2014 u zgjidh me mirëkuptim problemi i kontrollit të pronësisë mbi aksionet e CEZ Shpërndarje sh.a. ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A. S. Sipas kësaj Marrëveshjeje aksionet e CEZ Shpërndarje sh.a. i kaluan në pronësi shtetit shqiptar. Aktualisht shteti shqiptar zotëron 100 % të aksioneve të kësaj kompanie.

Në këto kushte me Vendimin nr. 98, datë 27.10.2014, Bordi i Komisionerëve të ERE-s vendosi përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" sh.a (OSHEE), sipas Vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.5, datë 21.01.2013. dhe licenoi për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes, si dhe aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike kompaninë shtetërore OSHEE sh.a

Të dhënat e raportuara nga kompania tregojnë për një nivel të humbjeve në rrjet për vitin 2014 në masën 37.81 % kundrejt 45.04%, në vitin 2013. Po ashtu ndjeshëm është rritur edhe niveli i arkëtimeve, i cili rezulton në shifrën 91.9% për vitin 2014. Këto të dhëna flasin për një zhvillim pozitiv në aktivitetin e OSHEE sh.a, të cilat reflektohen edhe në pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Raporti në vijim paraqet një pasqyrë të gjendjes së sektorit elektroenergjetik, nivelit të shërbimeve të ofruara nga operatorët publikë dhe privatë në tregun e energjisë elektrike bazuar në të dhënat që ERE administron në kuadër të autoritetit të

saj për rregullimin dhe monitorimin e aktiviteteve që ushtrohen nga subjekte të licencuara në sektorin e energjisë.

Gjatë vitit 2014 veprimtaria e Entit Rregullator të Energjisë u fokusua në administrimin e kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike e finalizuar me licencimin e kësaj kompanie më 27 tetor 2014.

Një tjetër zhvillim me mjaft rëndësi në tregun e energjisë elektrike ishte përcaktimi i çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike për vitin 2015, miratuar nga Bordi Komisionerëve të ERE-s më datë 26.12.2014.

Ky vendim i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) vjen në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore për përcaktimin dhe rregullimin e tarifave të shitjes me shumicë dhe me pakicë, afateve dhe kushteve të shërbimit të energjisë elektrike.

Vendimet e këtij viti bëhen për shkak të propozimeve të bëra pranë ERE-s nga kompanitë KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., kompani që sigurojnë këtë furnizim për klientët tariforë.

Në vendimin e tij Bordi i Komisionerëve u mbështet në argumentet dhe llogaritjet e kostove të argumentuara, në metodologjinë e caktimit të çmimeve dhe tarifave për konsumatorët fundorë, si dhe në mendimet dhe propozimet e palëve të interesuara të shprehura në seancën dëgjimore publike të zhvilluar me grupet e interesit.

Siç është raportuar edhe më parë, për shkak të operimit në treg të aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë nën statusin e administrimit të përkohshëm, ERE pezulloi procesin e rishikimit të të ardhurave të kërkuara të kompanive publike (KESH sh.a, OST sh.a, OSHEE sh.a) në vitet 2013 -2014.

Ky zhvillim bëri të pamundur zbatimin e mëtejshëm të përcaktimeve të Deklaratës Rregullatore dhe kushtëzoi vendimmarrjen e ERE-s për sa i takon nivelit dhe strukturës së tarifave për vitet kalendarike 2013 dhe 2014.

Përveç vendimeve të përcaktimit të tarifave dhe çmimeve për vitin 2015 për KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE sh.a, ERE në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi përcaktoi gjithashtu çmimet e shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj dhe ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 - 2014.

Vendimi për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2015 shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të reflektimit të kostove të argumentuara, për realizimin e furnizimit pa ndërprerje dhe me cilësi të energjisë elektrike të konsumatorëve tariforë.

Një efekt të rëndësishëm ky vendim kishte për shmangien e ndër-subvencioneve brenda kategorive të konsumatorëve.

Në përcaktimin e këtyre çmimeve është siguruar mbajtja e një tarife të pandryshuar për subjektet furra buke dhe prodhim mielli, duke mbajtur në këtë nivel shpenzimet e konsumatorit familjar për një nga produktet bazë.

Në tarifën e shpërndarjes nuk janë përfshirë kostot e shkaktuara nga humbjet jo-teknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes.

Në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, kërkesë e angazhimeve që vendi ka ndërmarrë në kuadër të implementimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ERE vijoi me përcaktimin e tarifës së përdorimit të rrjetit të shpërndarjes për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në vlerën 1.5 leke/kWh, e cila do të pasohet me vendimmarrjet e ERE-s në muajt e ardhshëm të kësaj tarife edhe për nivele e tjera tensioni 20 – 10 – 6 kV.

Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike do të krijojë nivele të tjera më të sigurta për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike.

Gjithashtu gjatë vitit 2014 ka pasur zhvillime të rëndësishme dhe në sektorin e gazit në hartimin dhe miratimin e disa akteve rregullatore të bashkërenduara me homologet tanë Grekë dhe Italianë që lidhen me tregëtimin dhe transmetimin e tij.

Në analizë të karakteristikave, zhvillimeve dhe problematikave që janë në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në vendin tonë, forcimi i kapaciteteve profesionale të ERE-es është një sfidë e rëndësishme e këtij institucioni me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi. Kjo bëhet më e rëndësishme në kuadër të implementimit të Paketës së Tretë të Energjisë të miratuar nga Komisioni Evropian.

Në procesin e ristrukturimit të tij sektorët e energjisë dhe gazit natyror janë përpara sfidash të medha dhe me përgjegjësi.

Zhvillimi i sektorit të energjisë është një nga garancitë për një zhvillim të qendrueshëm të ekonomisë së një vendi. Vlerësimi i këtij sektori, përditësimi dhe zhvillimi i bazës rregullatore, përbën një nga detyrat kryesore të Entit Rregullator për vitet në vazhdim.

Kryetari

**Petrit Ahmeti**



# HYRJE

Sektorit i Energjisë Elektrike dhe ai i Gazit Natyror në vendin tonë rregullohen në bazë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar. Në bazë të këtyre ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore është përcaktuar autoriteti i ERE-s për trajtimin e aplikimeve për liçensim, monitorimin e të liçensuarve, mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e tarifave në Tregun e Rregulluar të Energjisë Elektrike, miratimin e akteve nënligjore që lidhen me rregullimin e Sektorit të Energjisë Elektrike.

Në bazë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, ERE ka detyrimin që jo më vonë se data 31 Mars të raportojë në Kuvend mbi gjendjen e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, si dhe aktivitetet e ERE-s për vitin paraardhës.

## ***Struktura organizative e ERE-s***

ERE ushtron përgjegjësitë e saj në zbatim të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, përmes organit vendimmarrës të Bordit të Komisionerëve, i cili ndihmohet në punën e tij nga një staf teknik, staf mbështetës dhe specialistë të jashtëm. Struktura dhe organograma e ERE-s është miratuar me Vendim të Kuvendit Nr. 181, datë 05.05.2008.

## ***Bordi i Komisionerëve***

Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në bazë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s. Bordi i Komisionerëve përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Gjatë vitit 2014 kanë ushtruar detyrën si anëtarë të Bordit të Komisionerëve:

Z. Petrit Ahmeti..... Kryetar

Zj. Entela Shehaj..... Anëtare

Z. Adriatik Bego..... Anëtar

Z. Maksim Shuli..... Anëtar

Z. Abaz Aliko ..... Anëtar

Për qëllime të vendimmarrjeve, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi Bordi i Komisionerëve zhvillon mbledhje formale, takime konsultative, si dhe seanca dëgjimore publike.

Gjatë vitit 2014, Bordi i Komisionerëve ka zhvilluar 31 mbledhje formale, në të cilat janë marrë 157 vendime. Në shtojcat e këtij raporti janë paraqitur vendimet e marra gjatë vitit 2014 me përjashtim të vendimeve që lidhen me funksionimin e brendshëm të ERE-s.

Për sa përçaktohet në legjislacionin në fuqi në këtë raport Bordi i Komisionerëve edhe për vitin 2014 është mbështetur në punën e tij nga Këshilltari, Sekretari i Bordit dhe një personel teknik të organizuar në 4 drejtori si vijon:


- *Drejtoria e Administrim Financës dhe Burimeve Njerëzore*, me 8 punonjës.
- *Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike*, me 5 punonjës.
- *Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut*, me 7 punonjës.
- *Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*, me 5 punonjës

Gjatë vitit 2014 është synuar forcimi i kapaciteteve administrative të ERE-s përmes kualifikimeve të ndryshme të mbështetura nga rregullatori dhe nga organizmat ndërkombëtare të tillë si:

- **ERRA** - Energy Regulators Regional Association
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
- **NARUC** - National Association of Regulatory Utilities
- **MEDREG** - Mediterranean Energy Regulators
- **E-Control** - Energy Control Austria
- **AEEG** – Autorità per l'Energia Elettrica, il Gas ed i Servizi idrici in Italia

### ***Organograma e ERE-s***

Funksionimi i ERE dhe bashkërendimi i strukturave përbërëse të saj bëhet konform organogramës së mëposhtme.



**Organograma e ERE - 2014**



# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>I</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>V</b>
<b>1 RREGULLIMI NE TREGUN E ENERGJISE ELEKTRIKE .....</b>	<b>1</b>
1.1 TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	1
<b>2 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE .....</b>	<b>5</b>
2.1 HYRJE .....	5
2.2 KAPACITETET DHE PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	6
2.3 MBI KRITERET E SHFRYTËZIMIT TË REZERVËS HIDROENERGJETIKE NË KASKADËN E LUMIT DRIN 13	
2.4 REALIZIMI I TREGUESVE TË PRODHIMIT, MENAXHIMI I REZERVËS HIDRIKE.....	16
2.5 GJENDJA E TEC-IT VLORË.....	18
2.6 PRODHIMI NGA HEC-ET PRIVATE/KONCESION TË ENERGJISË ELEKTRIKE .....	19
2.6.1 Efiçienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike .....	24
<b>REFERENCA .....</b>	<b>26</b>
<b>3 TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE .....</b>	<b>27</b>
3.1 OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT.....	27
3.1.1 Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit .....	28
3.2 VEPRIMTARIA E OST.....	32
3.2.1 Investimet Kryesore për Zhvillimin e Sistemit të Transmetimit .....	32
3.3 PLANET E ZHVILLIMIT NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT .....	34
3.3.1 Projektet në proces implementimi.....	34
3.3.2 Projektet e planifikuara për zhvillimin afatshkurtër të Sistemit të Transmetimit .....	36
<b>REFERENCA .....</b>	<b>37</b>
<b>4 OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES.....</b>	<b>39</b>
4.1 STRUKTURA E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES.....	39
4.2 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE .....	43
4.2.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike.....	47
4.2.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike .....	49
4.3 IMPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE .....	50
4.4 EFIÇENCA E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE .....	51
<b>5 LICENSIMI DHE MONITORIMI I VEPRIMTARIVE NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE .....</b>	<b>57</b>
5.1 LIÇENCIMET DHE KËRKESAT PËR LIÇENCIM TË TRAJTUARA GJATË VITIT 2014 .....	57
5.1.1 Licensimet në Aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike .....	58
5.2 MONITORIMI I VEPRIMTARIVE NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE .....	60
5.2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike. Parimet.....	60
5.2.2 Monitorimi i KESH sh.a .....	61
5.2.3 Monitorimi i OST sh.a .....	63
5.2.4 Monitorimi i OSHEE sh.a.....	68
5.2.5 Monitorimi i Operatorëve të tjerë të Energjisë Elektrike .....	69
<b>6 RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR .....</b>	<b>71</b>
6.1 PRIORITETET E ERE PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR GJATË VITIT 2014.....	71

6.1.1	Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline).....	71
6.2	RRETH E CURISË TË DERITANISHME TË PROJEKTIT TAP-AG .....	72
6.2.1	Vendimi i Përfundimit të TAP AG-s.....	72
6.2.2	SDC (Southern Gas Corridor) FID & Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it (PCD)...	73
6.2.3	Progresi i projekteve SD2 (Shah Deniz 2) dhe SGC (Korridori i Jugut për Gazin) .....	74
6.2.4	Zgjatja e Periudhës së Përfundimit .....	76
6.3	DISA NGA ZHVILLIMET E TJERA MË TË RËNDËSISHME PËR VENDIN TONË NË LIDHJE ME PROJEKTIN TAP DERI NË FUND TË VITIT 2014. ....	76
6.3.1	Rreth vendimeve të marra dhe situatës së projektit. ....	76
6.3.2	Miratimi i Metodologjisë së Tarifave të Gazit Natyror .....	79
6.4	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	80
<b>7 AKTIVITETI I ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË.....</b>		<b>83</b>
7.1	AKTIVITETI I ERE-S NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË ÇMIMEVE DHE TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	83
7.1.1	Rishikimi i Tarifave .....	83
7.1.2	Tarifat e prodhimit të energjisë elektrike për KESH sh.a.....	85
7.1.3	Tarifa e Furnizimit Publik me Shumicë të energjisë elektrike.....	86
7.1.4	Llogaritja e tarifës mesatare për shërbimet ndihmëse .....	87
7.1.5	Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et ekzistues dhe HEC-et e rinj me fuqi të instaluar 15 MW .....	87
7.1.6	Mbi rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-et ekzistues dhe HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2013 dhe 2014.....	89
7.1.7	Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për HEC-et ekzistues dhe HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2015.....	90
7.1.8	Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. ....	92
7.1.9	Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për OSHEE sh.a.....	92
7.1.10	Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, viti 2014 .....	96
7.1.11	Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2014 .....	98
7.2	VEPRIMTARIA E ERE NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT .....	104
7.3	MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE DHE NDËRKOMBËTARE TË ERE-S.....	113
7.3.1	Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë .....	114
7.3.2	Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI).....	114
7.3.3	Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritetit .....	115
7.3.4	Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës .....	115
7.3.5	Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit .....	116
7.4	MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE.....	116
7.4.1	Pjesëmarrja Aktive si Anëtare e ERRA-s.....	117
7.4.2	Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s .....	118
7.4.3	Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare .....	118
7.5	ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE DHE BURIMEVE NJERËZORE TË ERE-S .....	119
7.5.1	Administrimi i Burimeve Njerëzore të ERE-s.....	119
7.5.2	Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s.....	120
7.5.3	Raporti i Auditimit nga Eksperti Kontabël për Vitin 2014.....	122
SHTOJCA 1 .....		131
RREGJISTRI I VENDIMEVE TË ERE-S PËR VITIN 2014.....		131




## **RREGULLIMI NE TREGUN E ENERGJISE ELEKTRIKE**

### **1.1 Tregu i Energjisë Elektrike**

Për vitin 2014, Tregu i Energjisë Elektrike ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.338, datë 19.03.2008, i cili ka miratuar Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike (MSHTEE). Veç të tjerash, ky model, ka përcaktuar pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike (TEE), si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg.

Për të adresuar dhe zgjidhur problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të këtij vendimi, si dhe në kuadër të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me aktet e Bashkimit Evropian, Modeli i Tregut gjatë viteve ka pësuar disa shtesa dhe ndryshime. Këto ndryshime dhe shtesa nuk kanë ndryshuar strukturën bazë të funksionimit të këtij tregu, si për efekt të flukseve të energjisë elektrike, marrëveshjeve të lidhjes në rrjet dhe të shërbimit të transmetimit përfshirë shërbimet ndihmëse, marrëveshjeve të furnizimit me energji elektrike, ashtu edhe të Fluksit të Fondeve.

Ne figurat ne vijim paraqiten Struktura e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Skema e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar.



**Figure 1-1:** Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut

(Burimi: ERE VKM nr.338 datë 19.03.2008 )

## SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figure 1-2: Skema e Sistemit Elektroenergjetik

(Burimi: ERE )



## **PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE**

### **2.1 Hyrje**

Prodhimi i energjisë elektrike prej shoqërive prodhuese realizohet si një aktivitet i licensuar nga ERE në bazë të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese me kapital tërësisht shtetëror dhe shfrytëzon centrale ekzistuese.

Shoqëritë prodhuese me kapacitetin më të madh prodhues janë të lidhura në sistemin e transmetimit. Këto subjekte të liçencuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese, apo dhe të reja kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare dhe, një pjesë e vogël, shfrytëzojnë centrale deri në 2 MW, të privatizuara në kuadër të Ligjit nr.8527, datë 23.09.1999.

Një numër i konsiderueshëm i shoqërive prodhuese është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes.



## 2.2 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga Shoqëria Aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore.

Pas shkëputjes nga administrimi publik i HEC-eve Ulëz, Shkopet, Bistrica 1,2 dhe Lanabregas, përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në Tabelën 1. Fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,350 MW dhe e TEC-it 98 MW.

Tabela 2-1 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik

KARAKTERISTIKAT E CENTRALIT	CENTRALET PRODHUESE PUBLIKE			
	HEC Fierëz	HEC Koman	HEC V.Dejës	TEC Vlorë
Nr.Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	<b>1448</b>			

(Burimi: KESH sh.a.)

Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privat të energjisë elektrike prej 375 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar në vendin tonë rezulton 1 823 MW. Prodhimi publik i energjisë elektrike në vitin 2014 u realizua 100% nga centralet hidroelektrike (HEC-et).

**Prodhimi neto prej 4,724,430 MWh u realizua:**

- **3,406,226 MWh** nga centralet prodhuese hidro të KESH sh.a (prodhimi publik)
- **1,318,204 MWh** nga hidrocentralet e tjere.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjate vitit 2014 është 1670 MW dhe prodhimi neto i tyre është 4 228 258 MWh.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2014 është 153 MW dhe prodhimi neto i tyre është 436 173 MWh.

Në tabelën 2-2 jepen të dhëna të gjithë centraleve, shoqërive, kapacitetit të instaluar dhe prodhimin neto për vitin 2014 të marra nga të dhënat e KESH sha.

Tabela 2-2 Prodhimi neto i te gjitha centraleve prodhuese gjate vitit 2014 (MWh)

SHOQERIA	CENTRALI	Kapacitet i MW	Tensioni i Lidhjes kV	Prodhimi MWh
KESH sha	HC Fierze 500 MW	500	110	1,055,071
KESH sha	HC Koman 600 MW	600	110	1,548,096
KESH sha	HC V. Dejes 200 MW	250	110	805,382
KESH sha	HC Theth			7
KESH sha	TEC Vlora	98	110	-2,330
Ujsjelles Kanalizime Tirane sha	Hec" Lanabregas" me fuqi 5 MW	5	110	32,726
KURUM INTERNACIONAL sha	Hec" Ulez" me fuqi 24 MW	24	110	110,388
KURUM INTERNACIONAL sha	Hec" Shkopet" me fuqi 24 MW	24	110	88,174
KURUM INTERNACIONAL sha	Hec" Bistrice 1" me fuqi 22,5 MW	23	110	167,905
KURUM INTERNACIONAL sha	Hec" Bistrice 2" me fuqi 5 MW	5	110	
Albanian Green Energy shpk	Smokthina (Vlorë)	9.2	35	34,202
Wonder Power sh.a.	Bogova (Skrapar)	2.5	35	6,787
Spahiu Gjanç sh.p.k	Gjanci (Korçë)	2.96	35	7,237
Hidro Albania Energji shpk	HEC Cernalev (Kukës)	6.73	35	14,784
HEC i Tervolit sh.p.k	HEC Tervoli (Elbasan)	12	35	33,762
HP Ostrovica sh.p.k	HEC Faqekuq 1 & 2 (Skrapar)	6.72	35	17,044
Hidroinvest 1 sh.p.k	HEC Stranik (Librazhd)	4.42	35	11,874
Ergo- SAS sh.p.k	HEC Sasaj (Sarandë)	8.6	35	28,190
Koka & Ergy Energy Peshk sh.p.k	HEC Peshk (Burrel)	3.43	35	10,693
Albanian Power shpk	HEC Martanesh (Bulqizë)	6	35	19,878
Hidroborsh sh.p.k	HEC Fterrë (Sarandë)	3.08	35	11,486
Selishtë shpk	HEC Selishtë (Dibër)	2	35	6,018
Hydro Power Plant of Korça shpk	HEC Verba 1, 2 (Korçë)	2.1	35	12,660
Energy Plus sh.p.k	HEC Pobreg	2	35	34,156
Snow Energy sh.p.k	HEC Koka 1	2.1	35	5,568
Hidroinvest 1 sh.p.k	HEC Zall Torre	3.33	35	9,229
Hec Velushë sh.p.k	HEC Vlushë (Skrapar)	14.2	35	6,837
Hec Qarr & Kaltanj sh.p.k	HEC Qarr	1.76	35	3,538
Hidro Energy Sotire sh.p.k	HEC Sotirë 1 & 2	2.29	35	4,491
Gjoka Konstruksion Energji sh.p.k	HEC Strelcë (Korçë)	4.16	35	2,622
Gjoka Konstruksion Energji sh.p.k	HEC Shalës (Shkodër)	2.08	35	20
Wenerg shpk	HEC Dardha (Korçë)	6.16	110	14,968
Power Elektrik Slabinje shpk	HEC Slabinjë (Korçë)	11	110	32,884
HEC Bishnica 1,2 sh.p.k	Bishnicë (Pogradec)	2.4	110	10,608
Gjo.spa. Power shpk	HEC Lapaj (Kukës)	13.6	110	41,799
Erdat Lura sh.p.k	HEC-et Lura 1, 2, 3 (Dibër)	16.12	110	41,626
Euron Energy Group shpk	HEC-et Bele 1, 2 (Kukës)	30.7	110	121,990
Energy Partners AL shpk	HEC Kaskada Cerruje	12.6	110	16,740
C&S Construction Energy shpk	HEC Rrapuni	4	110	33,958
Energji Ashta sh.p.k	HEC Ashta (Shkodër)	50	110	200,992
Marijakaj sh.p.k	HEC Bene (Shkodër)	0.26	6	1,432
WTS Energji sh.p.k	HEC Tamarë (Koplik)	0.15	10	1,146
WTS Energji sh.p.k	HEC Selcë (Koplik)	0.4	10	2,321
Maksi Elektrik sh.p.k	HEC 1 & 2 Leskovik (Kolonjë)	0.17	10	893
Amal sh.p.k	HEC Xhyrë (Librazhd)	0.57	10	1,594
Emikel 2003 sh.p.k	HEC Lenije (Gramsh)	0.4	10	3,029
Emikel 2003 sh.p.k	HEC Çorovodë (Skrapar)	0.2	10	827
Tucep shpk	HEC Tucep (Bulqizë)	0.4	10	1,102
Favina 1 sh.p.k	HEC Vithkuq (Korçë)	2.12	35/10	11,035
Juana sh.p.k	HEC Orenjë (Librazhd)	0.08	10	338
Sarolli sh.p.k	HEC Shpella (Pogradec)	0.46	10	1,432
Projeksion Energji sh.a	HEC Rehovë (Kolonjë)	0.36	10	0
Projeksion Energji sh.a	HEC Treskë 1 (Kolonjë)	0.45	10	0
Projeksion Energji sh.a	HEC Çarshovë (Përmet)			0
Balkan Green Energy shpk	HEC Bulqizë (Bulqizë)	0.6	10	1,411
Balkan Green Energy shpk	HEC Homesh (Bulqizë)	0.33	10	339

SHOQERIA	CENTRALI	Kapacitet i MW	Tensioni i Lidhjes kV	Prodhimi MWh
Balkan Green Energy shpk	HEC Zerqan (Bulqizë)	0.63	6	941
Balkan Green Energy shpk	HEC Arras (Dibër)	4.8	20	16,679
Balkan Green Energy shpk	HEC Lurë (Dibër)	0.75	10	525
Balkan Green Energy shpk	HEC Orgjost (Kukës)	1.2	10	4,535
Balkan Green Energy shpk	HEC Lekbibaj (Tropojë)	1.4	10	7,017
Balkan Green Energy shpk	HEC Dukagjin (Shkodër)	0.64	10	2,364
Balkan Green Energy shpk	HEC Marjan (Korçë)	0.2	10	579
Balkan Green Energy shpk	HEC Lozhan (Korçë)	0.1	10	334
Balkan Green Energy shpk	HEC Barmash (Kolonjë)	0.63	10	1,051
Balkan Green Energy shpk	HEC Treskë 2 (Kolonjë)	0.25	10	721
Balkan Green Energy shpk	HEC Nikolicë (Bilisht)	0.7	10	1,694
Balkan Green Energy shpk	HEC Funarë (Librazhd)	1.92	10	5,640
Balkan Green Energy shpk	HEC Lunik (Librazhd)	0.2	10	792
Balkan Green Energy shpk	HEC Kerpicë (Gramsh)	0.42	6	890
Balkan Green Energy shpk	HEC Ujanik (Skrapar)	0.63	10	1,238
Balkan Green Energy shpk	HEC Borsh (Sarandë)	0.25	6	1,026
Balkan Green Energy shpk	HEC Leshnicë (Sarandë)	0.38	10/6	728
Balkan Green Energy shpk	HEC Velçan (Korçë)	1.2	10	2,654
Balkan Green Energy shpk	HEC Sheshaj (Tropojë)			0
Balkan Green Energy shpk	HEC Voskopojë (Korçë)			0
Balkan Green Energy shpk	HEC Piqerras (Sarandë)			0
Balkan Green Energy shpk	HEC Muhur (Dibër)	0.25	6	1,074
Balkan Green Energy shpk	HEC Rajan (Kolonjë)	1.02	10	2,442
Duka T2 shpk	HEC Tuçep (Bulqizë)			0
EN-KU sh.p.k	HEC Bicaj (Kukës)	0.16	10	51
Ansara Konçension sh.p.k	HEC Ansara (Elbasan)	0.08	6	293
DN&NAT Energy sh.p.k	HEC Kumbull (Mirditë)	0.63	6	1,721
Dishnica Energy sh.p.k	HEC Dishnicë (Korçë)	0.2	10	491
Elektro Lubonje sh.p.k	HEC Lubonjë (Korçë)	0.3	10	242
Dosku Energy sh.p.k	HEC Gizavesh (Librazhd)	0.5	10	2,631
Erma MP sh.p.k	HEC Çarshovë (Përmet)	1.6	10	3,474
Çausi Energji sh.p.k	HEC Qafëzes (Ersekë)	0.4	10	1,893
Energji Xhaçi shpk	HEC Mollaj (Korçë)	0.32	10	817
Bekim Energjistik shpk	HEC Kryezi	1.2	10	3,394
Malido-Energji shpk	HEC Klos (Mirditë)	1.95	6	3,252
Korkis 2009 sh.p.k	HEC Belisovë (Berat)	0.15	6	213
Peshku Picar 1 sh.p.k	HEC Picar (Gjrokastër)	0.27	6	503
Erald Energjistik sh.p.k	HEC Mgull	0.4	10	1,436
LU&CO ECO ENERGY sh.p.k	HEC Ostren i Vogël	0.4	10	785
Idro Energia Pulita sh.p.k	HEC Ura e Dashit (Përmet)	1.19	10	2,367
E.T.H.H shpk	HEC Kozele (Ersekë)	0.55	10	560
SA.GLE. KOMPANI sh.p.k	HEC Trebishtë (Peshkopi)	1.98	10	2,214
Hydro Energy sh.p.k	HEC Murdharë 1 (Tiranë)	2.88	10	7,669
Hydro Energy sh.p.k	HEC Murdharë 2 (Tiranë)	1.44	10	3,616
Zall Herr Energji 2011 sh.p.k	HEC Çekrezë (Gramsh)	0.68	6	1,865
M.T.C Energy sh.p.k	HEC Radovë (Përmet)	2.93	10	2,600
Gur Shpatë Energy sh.p.k	HEC Gur Shpatë 1 & 2	1.35	10	461
		<b>1,823</b>		<b>4,724,430</b>




Figure 2-1 Prodhimi Neto Vendas për vitin 2014




Figure 2-2 Kontribuesit në Prodhimin Neto Vendas për vitin 2014




Figure 2-3: Prodhimi vendas për vitin 2014 krahasuar me periudhën 2007-2013





Figure 2-4: Prodhimi Neto vendas për periudhën 2007-2014

Siç duket dhe nga grafikët e mësipërm, nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2014 ka shënuar një prodhim të energjisë elektrike nga burimet vendase mbi nivelin mesatar. Po ashtu vlerësohet edhe shkalla e sigurisë nga pikëpamja hidrologjike.


Prodhimi maksimal mujor për vitin 2014, është shënuar në muajin dhjetor me 492,376 MWh. Ky prodhim i lartë është realizuar kryesisht nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. Prodhim i minimal gjatë vitit 2014 është realizuar në muajin shkurt me 354 610 MWh.

Në grafikun e Figurës 2-5 është paraqitur prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë gjatë periudhës 1985 deri në 2014. Sikurse vihet re nga krahasimi me rezultatet e prodhimit neto vendas të treguar më lart, prodhimi për vitin 2014 është 4,724 GWh pra një prodhim edhe mbi mesataren shumë vjeçare 1985-2014.



**Figure 2-5:** Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë për periudhën 1985 - 2014  
(Burimi: KESH,OST)

Për periudhën 2007-2014, ERE, nga administrimi i të dhënave të marra nga Operatorët Publikë, ka evidentuar në mënyrë të detajuar të dhënat e prodhimit të energjisë elektrike për çdo ditë të secilit vit.




**Figure 2-6** Historiku i Prodhimit (GWh) të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit  
(Burimi: OST)

Nga krahasimi i prodhimit të energjisë elektrike gjatë periudhës 2007 – 2014 vërehen diferenca jashtëzakonisht të mëdha. Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh, ndërsa prodhimi më i madh vjetor mbetet ai i vitit 2010 me 7,743.295 milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh.

Sikurse vihet re, diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstreme arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë të dukshme shkallën e lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga sistemet elektroenergetike të mbështetur vetëm në HEC-e.

Në Figurën 2-6 jepet historiku i Prodhimi i Energjisë Elektrike (GWh) nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për periudhën 1991 – 2014. ndërsa në Figurën 1-9 jepet prodhimi i Energjisë Elektrike (MWh) nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për periudhën 1991 – 2014.



**Figure 2-7** Prodhimi (MWh) i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2014

(Burimi: KESH,OST)


Në punën e hidrocentraleve evidentohet gatishmëri e lartë e të gjithë agregateve të centraleve. Është me rëndësi të theksohet se në sajë të kësaj gatishmërie është bërë e mundur që të derdhen vetëm sasi të vogla uji nga portat e centraleve, pa ju marrë më parë energjia. Këto derdhje rezultojnë të kenë qenë të paevitueshme dhe janë kryer për ruajtjen e parametrave të sigurisë së digave (Tabela 2-3).

**Tabela 2-3** Derdhjet nga Hec-et gjatë vitit 2014

HEC	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali (m <sup>3</sup> )
Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Koman	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vau Dejës	26	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26
Ulëz,Shkopet	0	0	0	23	41	4	0	0	0	0	0	0	68

### 2.3 Mbi Kriteret e Shfrytëzimit të Rezervës Hidroenergjetike në Kaskadën e Lumit Drin

Sikurse dihet baseni i HEC-it të Fierzës funksionon si rregullator vjetor i rezervës hidrike, çka ndikon drejtpërsëdrejti dhe në shfrytëzimin e kaskadës mbi lumin Drin(HEC-eve të Komanit,të Vaut të Dejës dhe të Ashtës), të cilët furnizohen kryesisht me ujë nga prurjet e rregulluara të HEC-it të Fierzës. Në figurën 2-8, jepet niveli në m i Liqenit të Fierzës për vitin 2014.


**Figure 2-8** Niveli (m) i Liqenit të HEC të Fierzës gjatëvitit 2014

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2014.



Tabela 2-4 Niveli i liqenit të HEC Fierëz për periudhën 1991 – 2014

Vitet	Niveli i HEC Fierëz (m)											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.4	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	267.7	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	281.5	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	277.5	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
Mesatarja	273.7	274.9	277.7	285.4	290.0	289.3	284.9	279.4	275.5	273.5	274.9	277.7
Minimumi	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	261.1	253.6	248.4	249.3	252.1
Maksimumi	291.1	290.8	294.4	296.9	296.9	296.2	294.3	291.5	289.4	288.3	289.2	288.0

Në Figurën 2-9 është paraqitur grafikisht për çdo muaj të vitit 2014 niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore për vitet 1991– 2014.

Në Figurën 2-10 paraqiten prurjet për vitin 2014 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike).




Figure 2-9 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesatarën, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 - 2014





Figure 2-10 Prurjet mesatare mujore (m<sup>3</sup>/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2014 krahasuar me mesatarën historike



**Figure 2-11** Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2014 (Burimi:OST)

Në grafikun e Figurës 2-11 është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike gjatë vitit 2014.

Kriteret e përpunimit të rezervës hidroenergjetike janë pothuajse analoge edhe në vitet paraardhëse.

## **2.4 Realizimi i treguesve të prodhimit, menaxhimi i rezervës hidrike.**

Gjendja e rezervës energjetike në fillim të vitit 2014 rezultoi rreth 650,000 MWh, respektivisht në nivelin 276.16 m në Fierzë. Ky nivel vlerësohet në kushte minimale të prodhimit të energjisë elektrike.

Politika financiare e KESH sh.a. për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve tariforë në vijim, detyruan prodhimin në regjim shfrytëzimi të përkeqësuar tekniko-ekonomik për KESH Gen.

Bazuar në gjendjen hidrike gjatë periudhës shkurt-maj prodhimi u reduktua rreth 180 GWh, me efekt rritje niveli në Fierzë rreth 6.4 m, referuar nivelit mesatar të shfrytëzimit për periudhën në vijim, për pasojë efica nca në prodhim u rrit me rreth 6% në HEC Fierzë, e barabartë me rreth 40,000 MWh përfitim.

Është ndjekur regjimi i punës për të maksimizuar efica ncën e potencialit energjetik në kushtet ku regjimet diktohen nga kërkesa për plotësimin e kërkesës të konsumatorëve tariforë, kur profili ditor i kërkesës luhatet në kufijtë 400 MW deri në 1475 MW në pik.

Gjatë vitit 2014, prurjet mesatare në Fierzë rezultuan rreth 143 m<sup>3</sup>/sek nga 196 m<sup>3</sup>/sek që është mesatarja shumëvjeçare.

Niveli në fund të vitit rezultoi 286.3 m dhe rezerva energjetike rreth 980 GWh me rritje rreth 325 GWh. Niveli mesatar i shfrytëzimit në HEC Fierzë rezultoi 284.8 m, në HEC Koman 173.05 m dhe prodhimi bruto i energjisë nga KESH Gen 3.412 GWh, duke përdorur për prodhimin e energjisë rreth 88% të prurjeve.

Në 10 vitet e fundit, niveli mesatar i shfrytëzimit rrespektivisht në HEC Fierzë rezulton 285.25 m, prurjet mesatare 190 m<sup>3</sup>/sek, niveli mesatar në fillim 278.99 m, niveli mesatar në fund 278.86 m, niveli mesatar i shfrytëzimit në HEC Koman 172.01 m, prodhimi mesatar i kaskadës 4.468 GWh.

Në 20 vjetët e fundit, niveli mesatar i shfrytëzimit në HEC Fierzë rrespektivisht rezulton 283.65 m, prurjet mesatare 187 m<sup>3</sup>/sek, niveli mesatar në fillim 275.7 m,

niveli mesatar në fund 277.89 m, niveli mesatar i shfrytëzimit në HEC Koman 171.58 m, prodhimi mesatar i kaskadës 4.333 GWh.


Niveli vjetor i shfrytëzimit për vitin 2014 në HEC Koman mesatarisht 173.05 m është niveli më i lartë mesatar historik i shfrytëzimit.

Nga krahasimi i prodhimit në raport me prurjet rezulton që prodhimi për 2014 është rreth 1% më i lartë se mesatarja e dhjetë viteve të fundit dhe krahasuar me njëzet vjetët e fundit është 1.5% më i lartë.


Treguesit e punës së hidrocentraleve më të mëdhenj të kaskadës së lumit Drin jepen në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 2-5** Treguesit e punës së hidrocentraleve

TREGUESIT E PUNES	HEC FIERZË	HEC KOMAN	HEC VAU I DEJËS
Niveli mesatar i shfrytëzimit (m)	284.8	173.04	74.24
Rënia (H) mesatare e shfrytëzimit (m)	111.24	98.61	51.04
Koefiçienti mesatar i ngarkimit të agregatëve (%)	92	78.4	85.6
Fuqia mesatare e hidrocentralit (MW)	119.2	178.7	91.3
Faktori kapacitetit	0.238	0.298	0.365
Prodhimi vjetor (MWh)	1,056,301	1,549,539	806,522
<b>Prodhimi vjetor i KESH (MWh)</b>	<b>3,412,362</b>		



**Figure 2-12** Niveli dhe prurjet ditore për vitin 2014



**Figure 2-13:** Niveli dhe Prodhimi ditor për vitin 2014




Figure 2-14: Krahasimi parashikues i prurjeve për vitin 2014




Figure 2-15: Prodhimi dhe prurjet për vitet 1991 – 2014

## 2.5 Gjendja e TEC-it Vlorë

Edhe gjatë vitit 2014 nuk është prodhuar energji elektrike nga TEC Vlora. Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve ende nuk është mundësuar vënia në punë e TEC-Vlora.

Sipas raportimeve nga KESH sh.a lidhur me kete problematike rezulton se:

- KESH sha dhe Kontraktori i ndërtimit të TEC-it janë në proces gjykimi për zgjidhjen e kundërshtive lidhur me defektin në sistemin e ftohjes dhe mbylljen e njëaneshme të kontratës nga TCM që në vitin 2012.
- Është shpallur një tender për përzgjedhjen e një kompanie të specializuar konsulence për projektin e riparimit të defektit në sistemin e ftohjes në TEC Vlora.

- KESH sh.a parashikon përgatitjen e një studim pre-fisibiliteti ku do të analizohet në mënyre krahasuese kosto e përdorimit të gazit natyror në prodhimin e energjisë elektrike nga TEC Vlora.

## 2.6 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike

Prodhimi dhe kapacitetet e HEC-eve Private dhe me Koncesion janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën 2-6. Gjatë vitit 2014 kanë prodhuar energji elektrike 98 centrale hidrike private / Koncesion. Nga keto 93 prej tyre kane pasur kontrate shitje me KESH, një është prodhues i shkëputur nga prodhimi publik por me kontrate shitje me FPSH kurse 4 te tjera kane prodhuar për nevojat e veta apo për tu tregtuar.

**Tabela 2-6** Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et Private/Koncesion për vitin 2014

N.	SHOQERIA	Centrali	Kapacitet i MW	Tensioni i Lidhjes kV	Prodhimi MWh
1	Wenerg shpk	HEC Dardha (Korçë)	6.16	110	14,968
2	Power Elektrik Slabinje shpk	HEC Slabinjë (Korçë)	11.00	110	32,884
3	HEC Bishnica 1,2 sh.p.k	Bishnicë (Pogradec)	2.40	110	10,608
4	Gjo.spa. Power shpk	HEC Lapaj (Kukës)	13.60	110	41,799
5	Erdat Lura sh.p.k	HEC-et Lura 1, 2, 3 (Dibër)	16.12	110	41,626
6	Euron Energy Group shpk	HEC-et Bele 1, 2 (Kukës)	30.70	110	121,990
7	Energy Partners AL shpk	HEC Kaskada Cerruje	12.60	110	16,740
8	C&S Construction Energy shpk	HEC Rrapuni	4.00	110	33,958
9	Energji Ashta sh.p.k	HEC Ashta (Shkodër)	50.00	110	200,992
10	Albanian Green Energy shpk	Smokthina (Vlorë)	9.20	35	34,202
11	Wonder Power sh.a.	Bogova (Skrapar)	2.50	35	6,787
12	Spahiu Gjanç sh.p.k	Gjanci (Korçë)	2.96	35	7,237
13	Hidro Albania Energji shpk	HEC Cernalev (Kukës)	6.73	35	14,784
14	HEC i Tervolit sh.p.k	HEC Tervoli (Elbasan)	12.00	35	33,762
15	HP Ostrovica sh.p.k	HEC Façekuq 1 & 2 (Skrapar)	6.72	35	17,044
16	Hidroinvest 1 sh.p.k	HEC Stranik (Librazhd)	4.42	35	11,874
17	Energjo- SAS sh.p.k	HEC Sasaj (Sarandë)	8.60	35	28,190
18	Koka & Ergy Energy Peshk sh.p.k	HEC Peshk (Burrel)	3.43	35	10,693
19	Albanian Power shpk	HEC Martanesh (Bulqizë)	6.00	35	19,878
20	Hidroborsch sh.p.k	HEC Ftterrë (Sarandë)	3.08	35	11,486
21	Selishtë shpk	HEC Selishtë (Dibër)	2.00	35	6,018

N.	SHOQERIA	Centrali	Kapacitet i MW	Tensioni i Lidhjes kV	Prodhimi MWh
22	Hydro Power Plant of Korça shpk	HEC Verba 1, 2 (Korçë)	2.10	35	12,660
23	Energy Plus sh.p.k	HEC Pobreg	2.00	35	34,156
24	Snow Energy sh.p.k	HEC Koka 1	2.10	35	5,568
25	Hidroinvest 1 sh.p.k	HEC Zall Torre	3.33	35	9,229
26	Hec Velushë sh.p.k	HEC Vlushë (Skrapar)	14.20	35	6,837
27	Hec Qarr & Kaltanj sh.p.k	HEC Qarr	1.76	35	3,538
28	Hidro Energy Sotire sh.p.k	HEC Sotirë 1 & 2	2.29	35	4,491
29	Gjoka Konstruksion Energji sh.p.k	HEC Strelcë (Korçë)	4.16	35	2,622
30	Gjoka Konstruksion Energji sh.p.k	HEC Shalës (Shkodër)	2.08	35	20
31	Marjakaj sh.p.k	HEC Bene (Shkodër)	0.26	6	1,432
32	WTS Energji sh.p.k	HEC Tamarë (Koplik)	0.15	10	1,146
33	WTS Energji sh.p.k	HEC Selcë (Koplik)	0.40	10	2,321
34	Maksi Elektrik sh.p.k	HEC 1 & 2 Leskovik (Kolonjë)	0.17	10	893
35	Amal sh.p.k	HEC Xhyrë (Librazhd)	0.57	10	1,594
36	Emikel 2003 sh.p.k	HEC Lenije (Gramsh)	0.40	10	3,029
37	Emikel 2003 sh.p.k	HEC Çorovodë (Skrapar)	0.20	10	827
38	Tucep shpk	HEC Tuçep (Bulqizë)	0.40	10	1,102
39	Favina 1 sh.p.k	HEC Vithkuq (Korçë)	2.12	35/10	11,035
40	Juana sh.p.k	HEC Orenjë (Librazhd)	0.08	10	338
41	Sarolli sh.p.k	HEC Shpella (Pogradec)	0.46	10	1,432
42	Projeksion Energji sh.a	HEC Rehovë (Kolonjë)	0.36	10	0
43	Projeksion Energji sh.a	HEC Treskë 1 (Kolonjë)	0.45	10	0
44	Projeksion Energji sh.a	HEC Çarshovë (Përmet)			0
45	Balkan Green Energy shpk	HEC Bulqizë (Bulqizë)	0.60	10	1,411
46	Balkan Green Energy shpk	HEC Homesh (Bulqizë)	0.33	10	339
47	Balkan Green Energy shpk	HEC Zerqan (Bulqizë)	0.63	6	941
48	Balkan Green Energy shpk	HEC Arras (Dibër)	4.80	20	16,679
49	Balkan Green Energy shpk	HEC Lurë (Dibër)	0.75	10	525
50	Balkan Green Energy shpk	HEC Orgjost (Kukës)	1.20	10	4,535
51	Balkan Green Energy shpk	HEC Lekbibaj (Tropojë)	1.40	10	7,017
52	Balkan Green Energy shpk	HEC Dukagjin (Shkodër)	0.64	10	2,364
53	Balkan Green Energy shpk	HEC Marjan (Korçë)	0.20	10	579
54	Balkan Green Energy shpk	HEC Lozhan (Korçë)	0.10	10	334
55	Balkan Green Energy shpk	HEC Barmash (Kolonjë)	0.63	10	1,051
56	Balkan Green Energy shpk	HEC Treskë 2 (Kolonjë)	0.25	10	721
57	Balkan Green Energy shpk	HEC Nikolicë (Bilisht)	0.70	10	1,694
58	Balkan Green Energy shpk	HEC Funarë (Librazhd)	1.92	10	5,640
59	Balkan Green Energy shpk	HEC Lunik (Librazhd)	0.20	10	792

N.	SHOQERIA	Centrali	Kapacitet i MW	Tensioni i Lidhjes kV	Prodhimi MWh
60	Balkan Green Energy shpk	HEC Kerpicë (Gramsh)	0.42	6	890
61	Balkan Green Energy shpk	HEC Ujanik (Skrapar)	0.63	10	1,238
62	Balkan Green Energy shpk	HEC Borsh (Sarandë)	0.25	6	1,026
63	Balkan Green Energy shpk	HEC Leshnicë (Sarandë)	0.38	10/6	728
64	Balkan Green Energy shpk	HEC Velçan (Korçë)	1.20	10	2,654
65	Balkan Green Energy shpk	HEC Sheshaj (Tropojë)			0
66	Balkan Green Energy shpk	HEC Voskopojë (Korçë)			0
67	Balkan Green Energy shpk	HEC Piqerras (Sarandë)			0
68	Balkan Green Energy shpk	HEC Muhur (Dibër)	0.25	6	1,074
69	Balkan Green Energy shpk	HEC Rajan (Kolonjë)	1.02	10	2,442
70	Duka T2 shpk	HEC Tuçep (Bulqizë)			0
71	EN-KU sh.p.k	HEC Bicaj (Kukës)	0.16	10	51
72	Ansara Konçension sh.p.k	HEC Ansara (Elbasan)	0.08	6	293
73	DN&NAT Energy sh.p.k	HEC Kumbull (Mirditë)	0.63	6	1,721
74	Dishnica Energy sh.p.k	HEC Dishnicë (Korçë)	0.20	10	491
75	Elektro Lubonje sh.p.k	HEC Lubonjë (Korçë)	0.30	10	242
76	Dosku Energy sh.p.k	HEC Gizavesh (Librazhd)	0.50	10	2,631
77	Erma MP sh.p.k	HEC Çarshovë (Përmet)	1.60	10	3,474
78	Çaushti Energji sh.p.k	HEC Qafëzes (Ersekë)	0.40	10	1,893
79	Energji Xhaçi shpk	HEC Mollaj (Korçë)	0.32	10	817
80	Bekim Energjitik shpk	HEC Kryezi	1.20	10	3,394
81	Malido-Energji shpk	HEC Klos (Mirditë)	1.95	6	3,252
82	Korkis 2009 sh.p.k	HEC Belisovë (Berat)	0.15	6	213
83	Peshku Picar 1 sh.p.k	HEC Picar (Gjirokastrë)	0.27	6	503
84	Erald Energjitik sh.p.k	HEC Mguill	0.40	10	1,436
85	LU&CO ECO ENERGY sh.p.k	HEC Ostren i Vogël	0.40	10	785
86	Idro Energia Pulita sh.p.k	HEC Ura e Dashit (Përmet)	1.19	10	2,367
87	E.T.H.H shpk	HEC Kozele (Ersekë)	0.55	10	560
88	SA.GLE. KOMPANI sh.p.k	HEC Trebishtë (Peshkopi)	1.98	10	2,214
89	Hydro Energy sh.p.k	HEC Murdharë 1 (Tiranë)	2.88	10	7,669
90	Hydro Energy sh.p.k	HEC Murdharë 2 (Tiranë)	1.44	10	3,616
91	Zall Herr Energji 2011 sh.p.k	HEC Çekrezë (Gramsh)	0.68	6	1,865
92	M.T.C Energy sh.p.k	HEC Radovë (Përmet)	2.93	10	2,600
93	Gur Shpatë Energy sh.p.k	HEC Gur Shpatë 1 & 2	1.35	10	461
<b>Prodhues qe kane patur kontrate me KESH (FPSH)</b>			<b>294.28</b>		<b>919,011</b>
1	Ujsjelles Kanalizime Tirane sha	Hec" Lanabregas" me fuqi 5 MW	5	35	32,726
<b>Prodhues i shkeputur nga KESH dhe qe ka patur kontrate me (FPSH)</b>			<b>5</b>	<b>35</b>	<b>32,726</b>



N.	SHOQERIA	Centrali	Kapacitet i MW	Tensioni i Lidhjes kV	Prodhimi MWh
1	KURUM INTERNACIONAL sha	Hec"Ulez" me fuqi 24 MW	24	110	110,388
2	KURUM INTERNACIONAL sha	Hec"Shkopet" me fuqi 24 MW	24	110	88,174
3	KURUM INTERNACIONAL sha	Hec"Bistrica 1" me fuqi 22,5 MW	23	110	167,905
4	KURUM INTERNACIONAL sha	Hec"Bistrica 2" me fuqi 5 MW	5	110	
<b>Prodhuues te Pavarur te Energjise (PPE)</b>			76		366,467
<b>Prodhuuesit total Private / Koncesion (PVE+PPE)</b>			<b>375</b>		<b>1,318,204</b>

(Burimi: KESH sh.a)

93 HEC-et që kanë pasur kontrate shitje me KESH, kanë një fuqi të përgjithshme të instaluar prej rreth 294.28 MW, nga të cilat rreth 37.49 MW përbëjnë HEC që kanë filluar prodhimin gjatë vitit 2014. Prodhimin e përgjithshëm për vitin 2014 nga këta gjenerues privatë/koncesion ishte 919 GWh ose 19.45 % e prodhimit të përgjithshëm neto vendas të vitit 2014. Në këtë grupim prodhueshish përfshihet edhe HEC Ashta me fuqi të instaluar mbi 15 MW (50MW) dhe që ka prodhuar gjatë 2014 rreth 201 GWh.

Një central, HEC Lanabregas, që është shkëputur nga KESH dhe ka pasur kontratë me KESH, ka një fuqi të instaluar prej 5 MW dhe ka prodhuar gjatë 2014 rreth 32.7 GWh.


Katër HEC- et: Ulez, Shkopet, Bistrica1 dhe Bistrica 2 që nuk kanë pasur kontratë me KESH, kanë një fuqi të instaluar prej 76 MW dhe kanë prodhuar rreth 366.5 GWh.

**Tabela 2-7** Prodhimin nga HEC –et të vegjel që kanë filluar prodhimin gjatë 2014

	Shoqeria	Centrali	Kapaciteti MW	Voltazhi i Lidhjes kV	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Netor	Dhjetor	TOTAL
1	Hec Vlushë sh.p.k	HEC Vlushë Skrapar	14.20	35	503	2,556	1,236	0	0	0	0	0	0	0	385	2,157	6,837
2	Hec Qarr & Kaltanij sh.p.k	HEC Qarr	1.76	35		970	648	483	202	108	92	177	164	216	477		3,538
3	Hidro Energy Sotire sh.p.k	HEC Sotirë 1 & 2	2.29	35			700	983	894	495	169	189	201	211	650		4,491
4	Gjoka Konstruksion Energji sh.p.k	HEC Strelcë (Korçë)	4.16	35						1,190	0	0	172	223	419	618	2,622
5	Gjoka Konstruksion Energji sh.p.k	HEC Shalës Shkodër	2.08	35						20	0	0	0	0	0	0	20
6	Idro Energia Pulita sh.p.k	HEC Ura e Dashit Përmet	1.19	10	505	315	350	481	19	25	2	1	94	191	383		2,367
7	E.T.H.H	HEC Kozele	0.55	10			134	156	65	0	0	0	0	47	54	104	560

		Ersekë															
8	SA.GLE. KOMPANI sh.p.k	HEC Trebishtë Peshkopi	1.98	10				938	773	144	0	0	0	0	25	335	2,214
9	Hydro Energy sh.p.k	HEC Murdharë I-Tiranë	2.88	10				1,812	1,995	617	170	130	576	372	558	1,440	7,669
10	Hydro Energy sh.p.k	HEC Murdharë 2 Tiranë	1.44	10				730	807	316	71	54	311	186	317	824	3,616
11	Zall Herr Energji 2011 sh.p.k	HEC Çekrezë (Gramsh)	0.68	6					351	127	96	33	282	297	320	360	1,865
12	MTC Energy	HEC Radovë Përmet	2.93	10						394	214	251	194	337	409	801	2,600
13	Gur Shpatë Energy Shpk	HEC Gur Shpatë I & 2	1.35	10									66	51	66	278	461
			37.49														38,862


Në tabelën 2-7 është paraqitur prodhimi vjetor i energjisë elektrike i HEC-eve të vegjël që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2014.



**Figure 2-16** Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private (Burimi: ERE)

Në grafikun e Figurës 2-16 është paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjël privatë ose të dhënë me koncesion (deri 15 MW), si dhe nga HEC Ashta gjatë periudhës 2006 – 2014. Duke marrë parasysh që prodhimi maksimal i vitit 2010 përveç rritjes së kapaciteteve të instaluar në një masë të madhe u ndikua nga kushtet shumë të favorshme hidrike, nga grafiku vihet ritmi i lartë i rritjes së prodhimit nga HEC-et e dhënë me koncesion, veçanërisht gjatë periudhës 2008-

2014. Një rritje e konsiderueshme u vërejt gjatë vitit 2013 ku prodhimi nga këto HEC-e ishte 2.5 herë më i madh në krahasim me vitin e mëparshëm. Kontribut të rëndësishëm në këtë rritje të prodhimit ka HEC Ashta, i cili gjatë vitit 2013 prodhoi 211 GWh ose 28% të totalit të prodhimit nga këto HEC-e.



**Figure 2-17** Detyrimet e KESH.sh.a ndaj subjekteve Private për Energjinë Elektrike  
(Burimi: KESH sh.a)

Në grafikun e figurës 2-17 janë paraqitur detyrimet e Furnizuesit Publik me Shumicë ndaj subjekteve private për energjinë elektrike të shitur tek KESH sh.a., e cila që në vitin 2012 arriti mbi 2.5 Miliard lekë, për vitin 2013 në 6.6 Miliard lekë dhe në vitin 2014 ka arritur rreth 8.1 Miliard lekë.

### 2.6.1 Efienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Sikurse evidentuar edhe në vitet e tjera, efienca e prodhimit të energjisë elektrike të sistemit tonë elektroenergjetik vlerësohet nga analiza e treguesve kryesorë në vijim:

1. Aftësia e akumulimit të energjisë elektrike në formë rezerve potenciale hidroenergjetike;
2. Aftësia për rregullimin e prurjeve në mënyre vjetore;
3. Optimizimi i kombinimit të prodhimit me importin e energjisë elektrike;
4. Fleksibiliteti i lartë ndaj ngarkesës, ç'ka i lejon të mbulojë lehtësisht pikun e ngarkesës;
5. Varësia e theksuar e prodhimit të energjisë elektrike nga kushtet hidrologjike të motit;
Për 42 aplikime për licensim Bordi i Komisionerëve ka vendosur licensimin e tyre, ndërsa 22 aplikime të tjera janë në proces dhe do finalizohen gjatë vitit 2015 në përputhje me afatet dhe procedurat e ERE-s.

Edhe gjatë këtij viti është respektuar me rigorozitet transparenca e parashikuar në procedurat për licensim, sikurse edhe zbatimi i afateve të shqyrtimit të aplikimeve dhe miratimit të pajisjes me licencë të subjekteve aplikues, në zbatim të Ligjit Nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licencave“. Gjithashtu në përputhje me kuadrin ligjor të mësipërm janë zbatuar me korrektësi afatet e publikimit në median e shkruar të Vendimeve të Bordit të Komisionerëve për njohjen e të gjitha palëve të interesuara

me këto vendime. Çdo aplikim për licencim i është nënshtruar analizës së rregullshmërisë dhe plotësisë me korrektesi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujerave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar të liçencohen.

Në tabelat në vijim jepen aplikimet për liçencë gjatë vitit 2014 dhe liçencimet e miratuara nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

**Tabela 5-1** Aplikimet për License dhe Licensimet e Miratuara nga Bordi i Komisionerëve sipas aktiviteteve të ndryshme gjatë 2014

Lloji i aplikimit	Numri i Aplikimeve
Aktivitet prodhimi të energjisë elektrike (3-ne proces)	11
Aktivitet tregtimi të energjisë elektrike (8 ne proces)	26
Aktivitet si furnizues i kualifikuar (7 ne proces)	11
Për rinovim licence	4
Për furnizim me pakice	1
Për shpërndarjen e energjisë elektrike	1
Për modifikim licence	1
Për transferim licence ( 2 ne proces)	2
Për aktivitet tregtimi të gazit natyror (1 ne proces)	1
Për kualifikim impianti (1 ne proces)	6

### 5.1.1 Licensimet në Aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Janë liçensuar për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike 8 shoqëri private për prodhimin e energjisë elektrike nga 15 impiante hidro (Hec-e) me një fuqi totale të instaluar 23,585 MW dhe një impiant Fotovoltaik me fuqi të instaluar 1 MW.

Nga këto impiante :

- 5 prej tyre janë me kapacitet deri në 1Mw
- 11 prej tyre janë me kapacitet 1-5 MW.

**Tabela 5-2** Liçencime për Prodhim të Energjisë Elektrike

SUBJEKTI	OBJEKTI	FUQIA E INSTALUAR MW
MTC ENERGY shpk	H/C RADOVE	2.5
GUR SHPATE ENERGY shpk	Gur Shpat 1	0.84
	Gur Shpat 2	0.83
EN REL HYDRO shpk	Zerec 1	0.55
	Zerec 2	1.315
BISTRICA 3 ENERGY shpk	H/C BISTRICA 3	1.57
	H/C BISTRICA 4	1.335
GJURR REC shpk	H/C MALLA	5.455
KOMP ENERGIJI shpk	H/C HURDHAS 1	1.71
	H/C HURDHAS 2	1.3
	H/C HURDHAS 3	1.2
SA' GA-MAT shpk	H/C GERMAN 1	1.2
	H/C GERMAN 2	1.68
	H/C GERMAN 3	1.29
	H/C GERMAN 4	0.81
UKKO sha	CENTRAL FOTOVOLTAIK	1

Tre subjekte të tjerë janë në proces licensimi për prodhimin e energjisë elektrike nga 7 impjante hidrike (Hec), me fuqi të instaluar 132.99 MW:

- **FATLUM** shpk , per HEC- PEROLLAJ me fuqi 0.5 Mw
- **DRAGOBIA ENERGY** shpk, per HEC –et Ceremi me fuqi 8.6 Mw dhe HEC Dragobia me fuqi 13.4 MW
- **Ayen as energji sha**, per HEC Gojan 12.25 Mw, Gjegjan 6.5 Mw, Peshqesh 27.94 Mw e Fangu 63.8 Mw

**Tabela 5-3** Aktivitete të tjera të Liçencuara

AKTIVITETE TE LICENSUARA	Nr. i Licencave te Miratuara	Ne proces Licencimi
Furnizues i kualifikuar i energjisë elektrike	4	7
Tregtues i energjisë elektrike	18	8
Modifikim i Licencës ekzistuese	1	0
Rinovim i Licencës ekzistuese	4	0
Kualifikim si burim i rinovueshëm energjie	5	1

## **5.2 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike**

### **5.2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike. Parimet**

Në zbatim të ligjit Nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neni 8, pika 2 gërmat f) dhe g) si dhe neni 63, shërbimet e operatorëve të liçensuar nga ERE-ja janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Monitorimet janë kryer bazuar në ligjin Nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në Rregullat e Tregut, si dhe të rregulloreve përkatëse mbi bazen e të cilave veprojnë pjesëmarrësit e tregut.

Këto monitorime janë kryer bazuar në plane tematike paraprake dhe organizuar në mënyrë të tillë që të monitorohen në vazhdimësi rezultatet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike. Proçesi i monitorimit është kryer duke ndjekur periodikisht hapat e mëposhtme.

- Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike (muajore) dhe informacioneve.
- Përpunimi i rezultateve dhe përcaktimi i vlerave të indikatorëve të performancës.
- Raportimi i analizës së treguesve të performancës së pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike pranë Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Diskutimi i zgjeruar i problematikave në mbledhjet periodike të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Përcaktimi i qëndrimit të ERE-s lidhur me performancën e operatoreve si dhe përgatitja e qëndrimeve dhe rekomandimeve për to.
- Identifikimi i çështjeve për monitorim në terren.
- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analizimi i tyre.
- Përcaktimi i qëndrimit dhe rekomandimeve të ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet

Në tabelën në vijim paraqiten të gjitha monitorimet e kryera gjatë vitit 2014 nga ERE.

Në këtë tabelë nuk janë përfshirë monitorimet me karakter verifikimi të kërkesë - ankesave apo treguesve të tjerë

**Tabela 5-4** Monitorime Tematike gjatë vitit 2014

Urdhëri i Monitorimit	Objekti i Monitorimit	Periudha	Kompania
Urdhër Nr. 7, datë 20.01.14	Me mundësinë e shkëputjes së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë nga Hec Ulëz - Shkopet	Fillon më 23.01.2014	KURUM HEC Ulëz-Shkopet
Urdhër Nr. 19, datë 14.02.14	Projekt Plani I Investimeve për vitin 2014	Gjatë muajit Shkurt	OST sh.a
Urdhër Nr. 28, datë 07.03.14	1. Zbatimin e Rregullore së Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s 2. Zbatimin e vendimit nr. 5, datë 17.01.2014 "Mbi ankandin e muajit Shkurt 2014 të Kapaciteteve të Interkonjeksionit"	Gjatë muajit Mars	OST sh.a
Urdhër Nr. 29, datë 07.03.14	Realizimin e procedurës së importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për muajt Janar-Shkurt 2014	Gjatë muajit Mars	CEZ Shpërndarje sh.a
Urdhër Nr. 30, datë 07.03.14	Transaksionet e shkëmbimit dhe eksport/importin e energjisë elektrike për muajt Janar-Shkurt 2014	Gjatë muajit Mars	KESH sh.a
Urdhër Nr. 39, datë 28.04.14	1. Analizimi I rezultateve të 3-mujorit të parë 2014 (KESH, OST, CEZ Shpërndarje) 2. Detyrimet për lidhjet e reja (OST, CEZ Shpërndarje) 3. Sistemi I faturimit sipas niveleve të konsumit (CEZ Shpërndarje)	28.04.14-15.05.14	KESH sh.a, OST sh.a, CEZ Shpërndarje sh.a
Urdhër Nr. 40, datë 25.04.14	Ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimin e energjisë elektrike për periudhën Janar - Mars 2014	14.04.14-21.04.14	CEZ Shpërndarje sh.a
Urdhër Nr. 46, datë 19.05.14	1. Kontrolli I zbatimit të vendimeve të ERE-s për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec Bene, 2. Realizimi I investimeve, 3. Marrëdhëniet kontraktuale me KESH sh.a	Gjatë muajit Maj	Marjakaj sh.p.k
Urdhër Nr. 68, datë 07.09.14	Ankesat e konsumatorëve lidhur me zbatimin e kushteve të kontratës për furnizimin me energji elektrike për konsumatorët familjarë dhe jo-familjarë si dhe Rregulloren për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit për periudhën Janar - Gusht 2014	10.09.14-20.09.14	OSHEE sh.a
Urdhër Nr. 74, datë 10.10.14	Analizimin e projekt-planit për investime për vitin 2015	Gjatë muajit Tetor	KESH sh.a, OST sh.a, OSHEE sh.a
Urdhër Nr. 84, datë 18.11.14	Investimet e propozuara në Planin e Investimeve për vitin 2015	Fillon në datë 18.11.2014	KESH sh.a
Urdhër Nr. 85, datë 18.11.14	Investimet e propozuara në Planin e Investimeve për vitin 2015	Fillon në datë 18.11.2014	OST sh.a
Urdhër Nr. 86, datë 18.11.14	Investimet e propozuara në Planin e Investimeve për vitin 2015	Fillon në datë 18.11.2014	OSHEE sh.a

**Shënim:** Në tabelën e mësipërme nuk janë përfshirë monitorimet me karakter verifikimi të kërkesë -ankesave apo treguesve të tjerë

## 5.2.2 Monitorimi i KESH sh.a.

Gjatë vitit 2014, ERE ka kryer monitorime kryesisht lidhur me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike, realizimin e investimeve si dhe analizimin e rezultateve të shoqërisë KESH sh.a.



Nga monitorimet e transaksioneve që kanë të bëjnë me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike është vënë re se blerja dhe shitja energjisë elektrike është bërë duke iu referuar:

- Plotësimin të kërkesës për energji elektrike për klientët tariforë OSHEE sh.a, FPP;
- Parashikimin të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për çdo muaj;
- Parashikimin të prodhimit të HEC-eve të vegjël;

dhe në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin e Nr. 30, datë 23.03.2011, si dhe me “Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2011.

Përsa i përket shkëmbimeve të energjisë elektrike për vitin 2014 u konstatua se shkëmbimi i energjisë elektrike që KESH sh.a ka kryer me tregtarët është bërë në bazë të kontratave të nënshkruara. Këto kontrata janë në harmoni me dispozitat e përcaktuara në Modelin Shqiptar të Tregut të energjisë elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008 dhe me Rregullat e Tregut të miratuara me Vendimin nr. 68, datë 23.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Planifikim-Realizimi i investimeve në KESH është monitoruar duke analizuar rezultatet e të gjithë periudhës së tretë rregullatore.

**Tabela 5-5** Tregues të investimeve 2012-2014 (periudha e tretë rregullatore)

Viti	Planifikimi i Investimeve në 000 lekë	Realizimi i Investimeve në 000 lekë	Realizimi i Investimeve (%)
2012	4,541,803	1,210,555	27%
2013	4,039,969	1,620,550	40%
2014	4,494,512	4,039,437	90%
Total	13,076,284	6,870,543	53%

Të gjitha këto mosrealizime të Planit të Investimeve kanë ardhur kryesisht për shkak të vështirësive shumë të mëdha financiare me të cilat është përballur dhe vazhdon të përballet shoqëria KESH sh.a., si rrjedhojë e mosarkëtimit në kohë të faturave për energjinë elektrike të lëvruar për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, (ish- shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a).

Duke qenë se shoqëria KESH sh.a nuk ka mundur të sigurojë burimet financiare të planifikuara nga të ardhurat e veta, kjo e fundit është detyruar që gjatë kësaj periudhe të rishikojë respektivisht planet e saj të investimeve si dhe të fokusohet tek projektet për punime dhe ndërhyrje emergjente në veprat hidroenergjetike të Kaskadës së Drinit.

Duke krahasuar raportin midis planifikimit të investimeve që përballohen nga shoqëria KESH sh.a. me fondet e veta (kostot lokale) dhe planifikimit të investimeve që përballohen nga fondet e huaja (kostot e huaja) që sigurohen nëpërmjet institucioneve financiare ndërkombëtare, vihet re se investimet e planifikuara të përballoheshin nga pjesa e fondeve të huaja janë realizuar në masën 65 %, ndërsa investimet e planifikuara të përballoheshin nga shoqëria KESH sh.a. me fondet e veta (kostot lokale) janë realizuar vetëm në masën 45%.

Gjithashtu ERE ka kryer monitorim mbi transparencën e Operatorëve në Tregun e Energjisë Elektrike për vitin 2014, përfshirë KESH sh.a në të cilën vërehet se shoqëria publikon në faqen e internetit të gjitha të dhënat e kërkuara sipas kuadrit ligjor.

### 5.2.3 Monitorimi i OST sh.a

Gjatë vitit 2014 ERE ka kryer monitorime për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga licensimi si dhe Rregullat e Tregut dhe akte të tjera ligjore në fuqi.

Realizmi i investimeve ka qenë një nga objektet e monitorimit. Nga monitorimi i investimeve në këtë kompani është vënë re se investimet në përgjithësi janë realizuar duke ndjekur planet afat-mesme me fonde të huaja si dhe planin e investimeve 2012-2014 miratuar nga ERE. Siç shihet nga tabela e mëposhtme, planet nuk janë realizuar sipas parashikimit për shkak të mos sigurimit në kohë të fondeve si dhe ka patur shmangie nga zërat e planeve për shkak të investimeve të detyrueshme për të realizuar sigurinë e sistemit.

**Tabela 5-6** Investimet ne OST sh.a


Lloji i investimeve	Programi i vitit 2014 (Million leke)	I Pritshmi i vitit 2014 (Million leke)
Investime me fondet e veta	2,306	1,158
Investime me financime të huaja	3,336	3,324

#### ***Disbalancat***

Në zbatim të ndryshimeve në Rregullat e Tregut për sa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-së, janë bërë llogaritjet e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu, në bazë orare. Çdo 10 ditë janë informuar nga OST sh.a Palët për disbalancat e kryera në mënyrë që të planifikojnë kompensimet përkatëse. Janë vlerësuar disbalancat e palëve në bazë mujore, të cilat më pas u janë faturuar pjesëmarrësve të tregut. Po kështu, në bazë mujore janë llogaritur dhe është kompensuar edhe shoqëria KESH sh.a për balancimin e Sistemit të Transmetimit.

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje në total e volumeve të devijimeve brenda intervalit prej  $\pm 3\%$  të pjesëmarrësve të tregut, për periudhën janar – dhjetor 2014. Disbalancat në këto kufi nuk penalizohen në vlera monetare, por kompensohen nga të dy palët në energji.

Penalizimet për devijimet që kanë shkaktuar Pjesëmarrësit e Tregut, jashtë intervalit  $\pm 3\%$  në MWh, përllogariten e faturohen sipas Rregullave të Tregut të miratuara me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s.



**Figure 5-1** Disbalancat brenda dhe jashtë zonës  $\pm 3\%$

### **Alokimi i Kapaciteteve të Interkonjeksionit**

Për vitin 2014 ERE ka kryer monitorime lidhur me zhvillimin e ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit.

Në përputhje me vendimet e ERE-s, shoqëria OST sh.a ka zhvilluar Ankandet Ditore (duke filluar nga data 1 shtator 2014 e në vijim), Ankandet Mujore të ATC në interkonjeksion, si edhe Ankandin Vjetor i ATC, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2014, sipas Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit (të ndryshuar).

Në Tabelën Nr 1 janë përmbledhur të dhënat e Ankandit Vjetor për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor të vitit 2014.

Gjithashtu janë paraqitur dhe vlerësuar 136 oferta, me një total prej 9.198.000 MWh, me një vlerë totale të ofertave prej 7.154.038 Euro.

Kanë rezultuar fituese në ankand 49 oferta, me një total prej 3.504.000 MWh, me një vlerë totale prej 3.004.680 Euro.

Evidentojmë se kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë më e shprehur në drejtimin import për Shqipëri, me një vlerë të ofertave prej 4.579.474 Euro, pra 64% e vlerës totale të ofertave.

Në drejtimin Export, dominon kërkesa për interkonjeksionin me Greqinë me një total prej 1.664.400 MWh (kundrejt 657.000 MWh të ofruar në ankand nga shoqëria OST sh.a), me një vlerë totale të ofertave prej 2.380.092 Euro.

Në përfundim të ankandeve nuk ka pasur ankesa të shprehur të pjesëmarrësve të tregut, për procedurat dhe rezultatet e ankandit.

Në Tabelën nr. 1 janë përmbledhur të dhënat e ankandeve Vjetore dhe Mujore për periudhën 1 janar deri në 31 dhjetor 2014.

**Tabela 5-7** Të dhënat e ankandit vjetor janar – dhjetor 2014

Vlera e Ofertave Fituese	Çmimi Mes i Ofertave Fituese	Numri Ofertave te Pjesëmarrësve	Numri Ofertave Fituese
Euro	Euro/MWh	Nr	Nr
1,331,520	<b>1.52</b>	34	10
43,800	<b>0.05</b>	19	12
387,630	<b>1.77</b>	25	5
32,850	<b>0.15</b>	14	5
32,850	<b>0.05</b>	17	8
1,176,030	<b>1.79</b>	27	9
1,752,000	<b>1</b>	76	23
1,252,680	<b>0.72</b>	60	26
3,004,680	<b>0.86</b>	136	49

**Tabela 5-8** Të dhënat e ankandit Total (mujo – vjetor) 2014

			Vlera e Ofertave te Pjesmarresve	Vlera e Ofertave Fituese	Çmimi Mes i Ofertave Fituese	Numri Ofertave te Pjesmarresve	Numri Ofertave Fituese
			Euro	Euro	Euro/MWh	Nr	Nr.
TOTAL -2014 (Ankande Mujore + Vjetor)	AL-ME	imp	15,016,119	5,928,385	<b>3.49</b>	435	141
		exp	159,138	48,096	<b>0.03</b>	114	105
	AL-RS	imp	11,347,792	4,220,599	<b>4.57</b>	658	192
		exp	291,587	59,176	<b>0.06</b>	165	116
	AL-GR	imp	129,101	46,458	<b>0.05</b>	85	58
		exp	7,240,431	3,359,331	<b>3.09</b>	336	113
	TOTAL OST	imp	26,493,012	10,195,442	<b>2.79</b>	1,178	391
		exp	7,691,156	3,466,603	<b>0.96</b>	615	334
		imp + exp	34,184,168	13,662,045	<b>1.88</b>	1,793	725

Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar nga komisioni përkatës i shoqërisë OST sh.a, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, si edhe me procedurat dhe udhëzimet apo vendimet përkatëse të ERE-s. Vlen të theksojmë në

këtë kontekst se, nuk ka pasur asnjë ankesë apo kundërshtim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për: afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimin e fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimin dhe publikimin e njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.

Aktualisht, në mungesë të Soft-it të operimit të tregut, është përdorur Platforma NOVITA, e cila ka bërë të mundur, që prej datës 1 shtator 2014 e në vijim, të organizohen ankandet ditore të alokimit të ATC në interkonjeksione.

Në përputhje me Vendimin Nr. 61, datë 07.07.2014 të ERE-s, janë hedhur nga shoqëria OST sh.a në ankandin ditor, kapacitetet e pa alokuara në ankandin vjetor, kapacitetet e pa alokuara në ankandin mujor të radhës, si edhe kapacitetet “e lira”, të cilat nuk janë nominuar në (D-2) nga palët e tregut.

Në grafikët e mëposhtëm janë përmbledhur të ardhurat për secilin kufi, si dhe pesha në përqindje që ka zënë importi dhe eksporti në ankandet e kapaciteteve për vitin 2014.




Figure 5-2 Grafiku i të Ardhurave nga Ankandet e vitit 2014




Figure 5-3 Grafiku në % sipas drejtimimit të Ankandëve për vitin 2014

Gjatë monitorimit mbi Lidhjet e Reja është konstatuar trajtimi korrekt i kërkesave sipas rregullores të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionarëve nr. 22, datë 25.02.2012 si më poshtë:

**Tabela 5-9** Kërkesat për tu Lidhur me Sistemin e Transmetimit - Viti 2014

Kërkesat për tu Lidhur me Sistemin e Transmetimit - Viti 2014						
Nr.	Lloji i Centralit	Shoqëria Aplikuese	Emertimi	Fuqia e Instaluar (MW)	Pika e lidhjes	Aplikime
1	Ngarkese	"A.S.C.Cr" shpk	Uzine Ferrokromi	12.50	Rrethi Mat	3
2		"AlbCHROME" shpk	Uzina e Ferro-Kromit	12.32	N/Stacioni 220/110/10 kV BURREL	
3		"GENER-2" shpk	Godine Polifunkionale	4.50	N/Stacioni 220/110/TM kV TIRANA1	
4	Gjenerues Hidro	"S.P.E. Gjader" shpk	HEC-et Gjader 1-2-3-4-5-6	21.64	N/Stacioni 110/20 kV HEC Ashta 1	12
5		"KUKUR ENERGY" shpk	HEC-et Kukur 1-2-3-4-5	21.36	N/Stacioni 110/TM kV Banje	
6		"Rajan Energy"	HEC-et e Kaskades Langarice	7.63	Linja 110 kV Erseke-Permet	
7		"VERNIK" shpk	HEC-et Vernik 1-2-3-4	11.68	Linja 110 kV Babice-Sarande	
8		"Vellezeri Tola" shpk	HEC Fushbull	21.52	Linja 110 kV Fiber-Librazhd	
9		"LIRIA ENERGI" shpk	HEC Shpella Poshre	2.30	N/Stacioni 110/35 kV HEC Bishnica	
10		"ACCES Energy Albania" shpk	HEC-et Kiri 1-2	25.19	N/Stacioni 110/TM kV Shkodra 1	
11		"KROI MBRET ENERGI" shpk	HEC-et Backe-Staravecke	10.20	N/Stacioni 110/TM kV Corovode	
12		"Wenerg" sha	HEC Dardha 2	3.50	N/Stacioni 110/TM kV HEC Dardha1	
13		"M.C. Inerte Lumzi" shpk	HEC Lumzi	10.48	Linja 110 kV Repe-F.Arrez	
14		"Energy Partners Al" shpk	HEC-et Shkalle-Cerujal-2; Rrupe-Klos	12.75	Linja 110 kV Sue-Bulgjeze	
15		"DITEKO" shpk	Kaskada e Okshunit	31.50	Linja 110 kV Bukqize-Shupenze	
16	Gjenerues Solar	"REN TTR 1" shpk	Impiant FV Novosele 1,2,3,4	60.00 (MWp)	Linja 110 kV Fier-Vlora1	1
17	Gjenerues me ERE					0
18	Gjenerues Termik					0
<b>TOTALI</b>						<b>16</b>

Gjithashtu në kuadër të monitorimit që ERE ka kryer mbi transparencën e Operatorëve të Tregut të Energjisë Elektrike, për vitin 2014 u konstatua se faqja e internetit e OST Sh.a është në proces rikonstruksioni dhe është lënë detyrë përmirësimi i të dhënave sipas kuadrit ligjor, në veçanti:

- Lista e palëve të regjistruara me informacion mbi emrin, numrin e identifikimit, datën e regjistrimit dhe statusin (tregtues, furnizues që furnizojnë me energji elektrike vetëm vendet e konsumit të tyre, datën e tërheqjes, datën e pezullimit, etj), sipas kapitullit III të pikës 3.5 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
- Të gjitha kontratat e rregulluara që miratohen nga ERE, me qëllim që të mbrojnë palët kontraktuese nga risku i ndryshimit të çmimit përmbyllës të tregut, sipas Kapitullit V, pika 2.1 e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
- Një listë që identifikon çdo Sistem Matës për të cilin kërkohet kontroll automatik dhe/ose komunikim, sipas Kapitullit XIV, pika 9.3 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
- Programet e lëvrimit për interkonjeksionet (Nominime) sipas procedurës përkatëse të OST-së dhe Rregullave të Tregut, Kapitulli XVI, pika 7 (ii).
- Informacionin dhe publikimin sipas kapitullit XVI, pika 8 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike për:
  - Parashikimin e kërkesave për rezerva të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;

- Parashikimin për shërbimet ndihmëse të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;
- Gjenerimin e disponueshëm – kapacitetin e pritshëm total të disponueshëm të gjenerimit;
- Kërkesën maksimale të pritshme dhe kërkesën mesatare orare në MW për çdo muaj në vitin kalendarik;
- Vlerësimet e humbjeve në sistemin e transmetimit në GWh në bazë javore;
- Vlerësimet e kufizimeve të parashikuara në sistem në GWh në bazë javore;
- Detajet mbi çdo situatë të parashikuar kur dhe ku do të kufizohet furnizimi.

1. Vlerën aktuale të Tarifës së Aplikimit dhe Tarifës së Mbikëqyrjes bazuar në pikën 4.4, të Rregullores së Lidhjeve të Reja.

#### **5.2.4 Monitorimi i OSHEE sh.a**

Gjatë vitit 2014 monitorimet tematike janë realizuar në zbatim të urdhërave të Kryetarit të ERE-s, ndërsa monitorimet periodike janë kryer në zbatim të planit të miratuar vjetor.

Nga monitorimi i kryer lidhur me realizimin e procedurës së importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes u konstatua se nuk ka pasur shkelje të ligjeve apo rregulloreve në fuqi. Procedurat e prokurimit për energjinë elektrike janë kryer në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat Standarte të Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSHEE”, miratuar me Vendimin Nr. 42, datë 25.05.2009 nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Nga monitorimi i kryer pranë Operatorit të Shpërndarjes u konstatua se lidhjet e reja të abonentëve për periudhën janar – mars 2014 janë realizuar mbështetur në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 22, datë 25.02.2012. Kriteret për vlerësimin e Lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese janë zbatuar sipas pikës 1.6 të kësaj Rregulloreje, si dhe procedura e ndjekur nga ana e shoqërisë është bazuar në pikën 2 të kësaj Rregulloreje.

Në lidhje me transparencën në Treg të Operatorëve të Energjisë Elektrike për vitin 2014 vërehet se në faqen e internetit të OSHEE sh.a nuk janë publikuar sipas kuadrit ligjor pikat si më poshtë vijojnë:

- Rezultatet e përpunuara të treguesve të cilësisë së vazhdueshmërisë së Furnizimit me energji elektrike për çdo zonë shpërndarje të klasifikuar brenda 31 marsit të

vitit pasardhës, sipas nenit 17, pika 3 të Rregullores për Kushtet minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

- Informacionet dhe të dhënat për shërbimet e kryera në vitin paraardhës, subjekte të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, sipas nenit 36, pika 3 të Rregullores për Kushtet minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

ERE ka kërkuar nga shoqëria OSHEE sh.a zbatimin e kuadrit ligjor për rritjen e transparencës në Tregun e Energjisë Elektrike.

Si rezultat i konstatimeve gjatë monitorimeve janë përgatitur disa rekomandime për tu përfshirë në planet afatshkurta apo afatmesme të shoqërisë.

REKOMANDIME LIDHUR ME DISA AKTIVITETEVE EMERGJENTE
Pergatitja e Draft Organogrames dhe struktures Organizative te OSSH ne kushtet e nje shoqerie me 100% aksione Shtetore dhe e menaxhuar nga disa pjese territoriale me ndarje te qarte Shperndarje-Furnizim
Kryerja e Inventarit te plote te Aseteve dhe Administrimi nepermjet SAP me te gjitha mundesite qe ai krijon.
Pergatitja e Planit te Investimeve 2015-2017 te prioritarizuar sipas nevojës dhe efekteve permiresuese.
Kryerja e nje studimi shoqeruar me Planin e Veprimit per saktesimin e bazes se te dhenave te elementeve te fatures ne sistemin e billingut per te gjithë klientet duke krijuar mundesine e monitorimit me baze kabine e fideri.
Kryerja e nje studimi me qellim percaktimin e detyres se projektimit per nje sistem te ri Billingut bashkekohor dhe qe ploteson kerkesat e OSHEE.
Kryerja e nje studimi tekniko-ekonomik shoqeruar me nje plan veprimi te detajuar lidhur me Plotesimin me matje te te gjithë Klienteve, Kabinave e fiderave
Pergatitja e Planit te Monitorimit periodik mujor te Bilancit energjistik me baze kabine.
Kryerja e nje studimi qe i hap rruge llogaritjes se humbjeve Teknike ne rrjetat e shperndarjes
Percaktimi i Targeteve te humbjeve dhe arketimeve per cdo kabine
Sigurimi i mjeteve per mirmbajtjen e investimet prioritare ne rrjetin e shperndarjes dhe furnizimit.
Organizimi i Nderprerjes se lidhjeve abuzive dhe realizimit te lidhjeve te reja ne afatet e percaktuara
Plotesimi me lexues te kualifikuar ne baze te normave te paracaktuara dhe pajisja e tyre me mjetet e nevojshme
Ballafaqimi i te dhenave periodike mujore te shitjes dhe arketimit nepermjet sistemit te Billingut
Sigurimi i te dhenave te arketimit ne kohe reale nga te gjithë aktoret e perfshire (cdo dite)
Pergatitja e nje studimi dhe nje plani te skeduar per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura
Pergatitja e nje studimi dhe nje plani per mbledhjen e detyrimeve te prapambetura nga klientet e OSHEE
Krijimi i kushteve per te matur ne menyre peridike performancen ne drejtim te cilesise se sherbimit
Realizimi i SKADA-s

## 5.2.5 Monitorimi i Operatorëve të tjerë të Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2014, ERE pervec monitorimeve nëpërmjet raportimeve periodike, ka ushtruar monitorime tematike edhe me shoqëritë si më poshtë vijnë:



Shoërinë KURUM International sh.a, ku objekt i monitorimit ishte mundësia e shkëputjes së furnizimit me energji elektrike të Operatorit të Shpërndarjes nga N/Stacioni i H/C Ulez për furnizimin e konsumatorëve tariforë.

Shoërinë Marjakaj sh.p.k ku objekt i monitorimi ishte verifikimi i ankesës së shoërisë Marjakaj sh.p.k për mosmarrëveshjet kontraktuale me shoërinë KESH sh.a, njëkohësisht për kontrollin e zbatimit të vendimeve të ERE-s dhe realizimin e investimeve nga kjo shoëri.

## **RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR**

### **6.1 Prioritetet e ERE për Sektorin e Gazit Natyror gjatë vitit 2014**

#### **6.1.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)**

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjise do të kryhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline, ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit TANAP deri në kufirin Turko-Grek. Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik për tu bashkuar me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane. Projekti është projektuar fillimisht të transportojë 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve. TAP është i projektuar gjithashtu që të mundësojnë rrjedhjen fizike të gazit në drejtim të kundërt.

Projekti TAP është zhvilluar nga kompania TAP AG. Aksionerët fillestarë të kompanisë kanë qënë: kompania zvicerane Axpo (42.5%), kompania norvegjeze Statoil ( 42.5 %) dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas (15%). Statoil është gjithashtu aksionere (25,5 %) në Konsorciumin Shah Deniz që është kompania që shfrytëzon SD2.

Në 30 korrik 2013 struktura e aksionereve të TAP ndryshoi si vijon; BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%) dhe Axpo (5%)

Dhe së fundmi ka patur përsëri ndryshim aksioneresh për të cilin janë njoftuar të gjithë palet e interesuara perfshi edhe tre autoritetet kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Që prej njoftimit të fundit më 23 korrik 2013 së fundmi ka pasur disa ndryshime në pronësinë e TAP AG - sidomos, dalje e përgjithshme e Total Gas Transport Ventures S.A.S. dhe E.ON (përmes Global Commodities SE) si aksionerëve dhe hyrjen e Enagás Enagás Internacional SLU.

Aksionerët aktualë paraqiten sipas tabelës mëposhtë:

**Tabela 6-1** Aksionerët aktualë

Aksionerët	Aksionerët përpara ndryshimit të parashikuar në 23 Korrik 2013	Aksionerët aktualë sipas 30 Shtatorit 2014	Ndryshimi
AzTAP (më parë e njohur si SOCAR GAS Pipelines GmbH)	20%	20%	0%
BP Gas Marketing Ltd	20%	20%	0%
Statoil ASA	20%	20%	0%
Fluxys Europe BV	16%	19%	+3%
Enagás Internacional S.L.U	0%	16%	+16%
Axpo Holding AG	5%	5%	0%
Total Gas Transport Ventures SAS	10%	0%	-10%
E.ON Global Commodities SE	9%	0%	-9%

## 6.2 Rreth ecurisë të deritanishme të projektit TAP-AG

### 6.2.1 Vendimi i Përfundimit të TAP AG-s

Marrëveshjet e Qeverisjes midis aksionerëve nuk kanë ndryshuar që nga ndryshimi i mëparshme në aksionet e Trans Adriatik Pipeline AG, më 23 korrik, 2013.

TAP, ka një gjatësi rreth 870 kilometra. Gjurma e tij fillon në kufirin Turko-Grek, kalon nëpër territorin grek dhe hyn në Shqipëri në zonën e Bilishtit. Ai përfshikon 204 kilometra në Shqipëri (nga Bilisht- Qendër në kufirin greko shqiptar deri në zonën

bregdetare në Seman në veri te Fierit), shtrihet 105 kilometra nëpër Detin Adriatik, del në Melendugno dhe vazhdon edhe 5 kilometra në territorin Italian.

Final Joint Opinion i qershorit 2013 percaktonte se Vendimi Perjashtues do të humbte efektin dhe vlefshmerine e tij nëse ndertimi nuk do të fillonte brenda 3 viteve (pra, brenda Qershorit 2016) dhe nese nuk fillonte veprimtaria operationale brenda 6 viteve te ardhshme. Gjithsesi, Komisioni i BE-se do të mund të aprovonte një shtyrje në rastin e ndonje vonese të shkaktuar nga pengesa madhore përtej fuqise së TAP-it. (kjo bazuar në nenin 36.9 te Direktives 79/2003/EC.

Në vendimin e Komisionit European të majit 2013 parashikohej se roli TAP-it është vetem një nga elementet në vazhden e investimeve që nevojiten të kryhen për të siguruar prodhimin e Gazit të Shah Deniz 2 dhe transportimin e gazit për në BE. Vecanërisht, vendimi parashikonte se TAP-i nuk ka asnje influence mbi zhvillimin e e mëtejshem të procesit; pra, asnje influence mbi fushen e gazit te Shah Deni 2, infrastrukturen e transportit nga Azerbaxhani per në Gjeorgji, si dhe infrastrukturen e trasnportit përgjatë Turqisë.

Në kohën që është marrë Vendimi Perjashtues për TAP-in, janari i 2019-s është vleresuar si periudha kohore kur gazi do të hyje për herë të parë në sistemin e TAP-it.

## **6.2.2 SDC (Southern Gas Corridor) FID & Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it (PCD).**

Duke marrë parasysh që Southern Gas Corridor (Korridori i Jugut te Gazit) është një projekt zinxhir kompleks, nevojitet të mundësohet njëfarë fleksibiliteti në PCD (Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it) në mënyrë që të sinkronizohen të gjithë elementet e këtij procesi zinxhir.

Përsa i përket TAP-it, procedura për të përcaktuar PCD-n përshkruhet në Marrëveshjen për Përcaktimin e Tarifave (TDA) të korrikut 2013, ku palet që kane rënë dakort janë BP Exploration (Shah Deniz) Limited (për llogari të South Gas Corridor), SOCAR dhe TAP AG. Në TDA është sanksionuar e drejta e SDC-se për të përcaktuar PCD brenda parametrave të përcaktuar.

Në gusht 2013, të tre Rregullatorët Kombëtare u njoftuan nëpërmjet një shkrese të hartuar nga TAP-i ku përmbledhej TDA-ja (Marrëveshja e Përcaktimi të Tarifave), përfshire edhe parimet e ‘funneling mechsansim’. Procesi për të përcaktuar PCD është gjithashtu i përfshire në versionin final të Kodit të Tarifës së TAP-it, i cili u miratua nga Rregullatorët Kombëtare në Nentor të 2013-ës.

Duke marre parasysh që Vendimi Përjashtues për TAP-in u miratua., plani i ndertimit inxhinierik të Shah Deniz 2, si dhe plani i punës u azhornuan, kjo përfshirë edhe daten optimale fillestare të eksporteve për ne BE. Konsorciumi Shah Deniz tashmë po synon per të shpërndarë gazin në Europë në fillim 2020- , nje vit pasi gazi i parë është prodhuar offshore në Azerbaxhan.

SDC-ja ndërmori Vendimin Final të Investimeve ne 17 Dhjetor 2013. Në perputhje me dispozitat e TDA-s (Marrëveshja për Percaktimin e Tarifave), SDC-ja (Southern Gas Corridor) informoi TAP-in se Periudha e Pare e Dritares (Window) - përgjatë së cilës do të zbatohet PCD-ja . Me pas, në 16 dhejtor 2014 SDC-ja njoftoi TAP-in se Periudha e Dritares së Dytë (Second Window) – përgjatë së cilës do të zbatohet PCD-ja.

PCD-ja (Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it) do të mund të zbatohet vetëm brenda periudhës kohore 1 vjecare, dhe JO pertej kësaj periudhe. Qartësisht, data më e vonët kur do te zbatohet PCD-ja është 31 Dhjetor 2020. Nuk ekziston asnjë mekanizëm kontraktor që do të lejonte shtyrjen e zbatimit të PCD-s përtej vitit 2020.

Duke krijuar një mekanizem bashkëpunues, TDA-ja (Marrëveshja për Percaktimin e Tarifave) funksionon si një mjet për të siguruar një zhvillimi eficient dhe me kosto efektive për projektin e TAP-it, duke mundësuar njëhsimin (sinkronizimin) e orarëve për elementët e tjerë zinxhir të Shah Deniz 2.

Duke marrë parasysh keto njoftime nga SDC-ja, TAP-i tashmë kerkon një shtyrje të periudhës të parashikuar në Vendimin Përrjashtues, për një periudhë 25 vjecare nga data më e vonët e mundshme me fillimin e zbatimit të PCD-s (Datës së Planifikuar të Fillimit të TAP-it).

### **6.2.3 Progresi i projekteve SD2 (Shah Deniz 2) dhe SGC (Korridori i Jugut për Gazin)**

Projektet SD2 (Shah Deniz 2) dhe SGC (Korridori i Jugut për Gazin) përfshijnë komponentë në drejtim dhe në drejtim të kundërt të rrjedhës së projektit TAP duke përfshirë: veprimet në offshore (det të hapur) dhe ngritjen e prodhimit për të arritur në rezultatin e një rafshnalte; projekte të tjera të gazsjellesit sic janë zgjerimi i gazsjellesit të Jugut Caucasus që nga Azerbaixhani përmes Gjeorgjisë dhe TANAP në Turqi, dhe pastaj lidhja me sistemin e Gazit SNAM në Itali.

Me një kosto të kombinuar prej të paktën 45 miliard\$ SD2 (Shah Deniz 2) dhe SGC (Korridori i Jugut për Gazin) përbëjnë një nga projektet më të mëdha energjetike në botë në fazën e “ekzekutimit të projektit” dhe formojnë projektin më të madh me të cilin po perballet Europa me nje burim të ri gazsjellësi.

#### ***Detajet e projektit***

- SD2 pritet që të sigurojë 16 miliard metra kubik për gazin (bcma) në vit për miliona konsumatorë nëGjeogji, Turqi, Greqi, Bullgari dhe Itali.
- Shpërndarja e SD2 (Shah Deniz 2) dhe SGC (Korridori i Jugut per Gazin) do të kërkojë nje bashkëpunim të ngushtë midis 10 kompanive investuese, 7 qeverive dhe 11 blerësve me shumicë të gazit.

- Shah Deniz do të dislokojë teknologjine e parë të prodhimit nën detin Kaspik, dhe do të përdorë zgjidhje të avancuara për shpim, për të përfunduar tek pusët të cilat shpërndajnë gaz në perqindjet më të larta në botë.
- Rrjeti i gazsjellesit 3500 km të gjatë SGC (Korridori i Jugut për Gazin), i cili përbëhet nga SCPX, TANAP, dhe projektet e gazsjellësit TAP mund të zgjerohen dyfish nga kapaciteti i tyre fillestar për të vendosur pjesën shtesë.
- Dispozitat janë bërë për të zgjeruar PSA të Shah Deniz që nga 2036 deri në vitin 2048, duke hapur zhvillimet e tjera në të ardhmen të rezervuareve të thellë të Shah Deniz.

#### ***Aktivitetet gjatë 2014 dhe zotimi për të zbatuar kontratat***

- Projekti SD2 (Shah Deniz 2) ka hyrë në fazën e ndertimit me aktivitete të detajuara inxhinierike, ato të shpimit dhe të ndertimit paraprak të cilat janë në vazhdimësi e sipër. Shpenzimet totale për SD2 (Shah Deniz 2) upstream (në drejtim të rrjedhës) dhe SCPX në vitin 2014 priten që të jenë rreth 5 miliard \$. Shembuj të kontratave të cilat janë mbyllur në vitin 2014 janë:
- KBR për sigurimin e teknikave të detajuara, menaxhimit të projektit dhe shërbimeve mbështetëse të prokurimit; me një vlerë 365 milion\$.
- Aleanca Tefken-Azfen do të kryejë ndertimin e gazit shtese dhe do të forcojë mjetet përpunuese në Terminalin Sangachanal në Baku; me një vlerë 998 milion dollarë.
- Konsorciumi AMEC-Tekfen-Azfen (ATA) për prodhimin e njësisë të platformave të Fazës së 2-të kantieri i prodhimit ATA në Bibi-Heybat afër Baku; me një vlerë 974 milion\$.
- Faza fillestare e teknikave për pjesën e nën-detit dhe gazsjellesit si dhe shërbimet për menaxhimin e projektit me vlerën 57 milion\$, i janë dhënë Wood Group Kenny Limited (WGK).
- Tek SCPX, kontrata për ndertimin dhe suportin për shërbimet e projektit SCPX në Gjeorgji i është dhënë sipërmarrjes së përbashkët Bechtel Enka.
- CBI do t'i sigurojë gazsjellësit dhe shërbimeve SCPX shërbime teknike dhe për menaxhimin e projektit.
- CSM Bessac do të kryejë ndertimin e boshtit dhe tunelit si dhe instalimin e vijës së tubacionit për dy kalimet nga njëri breg në tjetrin të lumit për projektin SCPX.
- Kontrata 26 milion\$ për shpimet horizontale drejtuese dhe instalimin e vijës së tubacionit për pesë kalimet e lumit të projektit SCPX i është dhënë Drill Tec GmbH.
- Kontrata Istiglal për Shpimin i është dhënë CDC, ndërkohë që Kontrata Maersk Heydar Aliyev i është dhënë Maersk.

- Konsorciumit BoS Shelf/Saipem/Star Gulf i është dhënë kontrat për të dyja marinat detare të përfshira dhe prodhimin offshore (në det të hapur).
- Kantieri detar i Baku është kontraktuar nga Anija e Ndërtimit në Nëndet.

ShawCor në Hollande B.V. (Bredero) i janë dhënë dy kontrata me një vlerë të kombinuar prej 226 milion\$. Këto kontrata mbulojnë aplikimin për mos-gerryerjen dhe shtresën për peshën e betonit për eksportin e gazsjellësit Shah Deniz 2 në nëndet, dhe përmiresimin e centralit Caspian Pipe Coating (CPS) në Baku.

#### **6.2.4 Zgjatja e Periudhës së Përjashtimit**

Që prej projektit SD2 (Shah Deniz 2) FID në dhjetor të vitit 2013, SDC (Shah Deniz Consortium) ka bashkëpunuar me TAP për një numër çështjesh të programuara të projektit. TAP është njoftuar që gazi i parë të TAP do të jetë midis datës 1 Janar 2020 dhe 31 Dhjetor 2020. Në tërësi kompleksiteti i SD2 (Shah Deniz 2) dhe projektit SGC (Korridorit të Jugut për Gazin) shkalla, pjesëmarrja e një numri të madh të paleve dhe paleve të interesuara, përmbajtja gjeopolitike, një levizje ndërkufitare e 7 vendeve të gazit, kërkon që një farë tolerance kohore të lejohet në mënyrë që të shmangen kostot e panevojshme për shkak të pjesëve të një vlere në vazhdimësi e cila është gati me shpejt se të tjerat. Funneling mechanism sipas TDA (Marreveshja për Përcaktimin e Tarifave) është caktuar të sigurojë këtë tolerance sipas kufijve të rënë dakord, dhe mbështetjes së SDC (Shah Deniz Consortium) e mbështet kërkesën e TAP-it, e cila njihet dhe përshtatet brenda Përjashtimit.

### **6.3 Disa nga zhvillimet e tjera më të rëndësishme për vendin tonë në Lidhje me Projektin TAP deri në fund të vitit 2014.**

#### **6.3.1 Rreth vendimeve të marra dhe situatës së projektit.**

Enti Rregullator i Energjisë ka një bashkëpunim të shkëlqyer me Entin Rregullator të Greqisë dhe Italisë, dhe kanë marrë vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG, në përputhje të plote me Direktivat e Parlamentit Europian dhe të Keshillit, pamvarësisht se këto Direktiva nuk janë të reflektuara në ligjet tona aktuale, por, ne po punojmë për reflektimin e këtyre direktivave në ligjin e ri të gazit i cili shumë shpejt do të vijë në Parlament për tu miratuar.

Vlërësimin e punës tonë të përbashkët të tre Autoriteteve Rregullatore e ka bërë edhe Komisioni Europian në Bruksel, me datë 13.10.2014, i cili në raportin final të: "Progress towards completing the Internal Energy Market" ka thënë në mënyrë eksplicite: Bashkëpunimi midis Greqisë, Italisë dhe Shqipërisë, i mbështetur nga

Komisioni, ka qenë një shembull efektive në vendosjen e një kuadri të përshtatshëm rregullator për TAP, i cili do të sjellë burime shtesë të gazit nga rajoni i Kaspikut në tregun e BE”.

Deri tani ne kemi marrë shumë vendime të përbashkëta, të cilat kane bërë që projekti TAP të mos pengohet, perkundrazi ta përshpejtoje atë, ne kushtet kur dhe kriza e energjisë kërcenon rajonin tonë.

Vendimet e marra për ecurinë e projektit TAP, sic janë përmendur edhe më sipër, janë në përputhje të plotë me Direktivat e BE-se, pasi keto vendime meren ne të njëjten kohë, ore dhe ditë kur i marrin edhe Autoritetet Italiane dhe Greke, të cilat janë anëtare të BE-së, dhe zbatojnë direktivat dhe ligjet e tyre. Kjo do të thotë që, me miratimin e ligjit të ri të gazit, brenda këtij viti, ne do të marim vendime, por tashmë të bazuara në ligjin e miratuar në Parlamentin tonë, ky ligj do të jetë në përputhje të plotë me Direktivat e BE-se.

Enti Rregullator i Energjisë mbas shumë diskutimesh dhe negociatash me përfaqësuesit e TAP-AG në lidhje me vlefshmërinë e aplikimit të Albpetrol sh.a në fazën e Prenotimit të Kapaciteteve të TAP (Booking Phase), e konsideron si shumë të rëndësishme arritjen e rezultateve të deritanishme.

Në letrën e fundit të dërguar nga TAP-AG, me subjekt: Procedurat nën fazën e parë të rezervimeve (Proceeding under the First Booking Phase), TAP-AG angazhohet për ndërtimin e një pike hyrje/dalje (exit/point) në KUCOVE me kapacitet 3.5 bcm/vit(3.5 miliard metër kub gaz në vit), i cili është edhe një detyrim që vjen nga Final Joint Opinoin, por njëkohësisht TAP-AG garanton edhe një pike tjetër në FIER (the initial Albanian Exit Facility), me të gjitha pajisjet e kërkuara (si pajisje per reduktimin e presionit, pajisje matje, stacion kompresori etj). Mendojme se është detyre e Ministrise për saktësimin e kapacitetit të kësaj pike si edhe te këtyre pajisjeve në bashkëpunim me TAP-AG dhe sigurisht bërjen efektive të tyre në marrëveshjet që rrjedhin nga Host Government Agreement.

Njëkohësisht TAP-AG angazhohet si pjesë e procedurave të First Booking Phase, që përvec angazhimeve të tjera TAP-AG do të vazhdoje të diskutojë me MEI për procedurat e mëtejshme që rrjedhin nga Host Government Agreement, të cilat janë një shenjë e qartë e vendosmërisë së TAP-AG për të vazhduar bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet ERE dhe MEI.

Kjo gjë sigurohet edhe në letrën drejtuar tre Autoriteteve të Greqise, Italisë dhe Shqipërisë , mbi Vlefshmërinë e Booking Request, ku në mënyrë eksplicite thuhet:

“Angazhimin e mëtejshëm të TAP për të vazhduar diskutimin me Albpetrol për të arritur një zgjidhje të mundshme për dëshirën e saj për të marrë kapacitete në tubacionin TAP, ashtu dhe si shprehet ne letrën dërguar ERE-s.”

Mendojmë që pasiguritë që ka TAP-AG, Entet Rregullatore të Greqisë dhe Italisë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Komisioni European për Albpetrol sh.a si një TSO e ardhshme e gazit, janë të arsyeshme, sepse kërkohet të punohet me intensitet për: kompetivitetin e kompanise : ku ndër të tjera kemi parasysh sjelljen në



gjendje pune të rrjetit ekzistues të gazit, ndarjen e licensave të transmetimit nga ai i shpërndarjes, pajisjen me personelin e duhur dhe krijimi i një kontigjenti specialistesh për aplikimin e tregut të gazit në një kohe sa më të shkurtër, ndërtimi i kodeve të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes dhe shumë elemente të tjera me synim përgatitjen për hapjen e tregut të gazit që aktualisht në vendin tonë është i munguar.

Ne gjithashtu kemi bashkëpunuar me MEI për hartimin e ligjit të ri të gazit, i cili ka në themel, "Aplikimin e Paketës së Tretë të Energjisë", kjo paketë ka filluar të aplikohet në janar 2015, për të gjitha vendet që kërkojnë të futen në Bashkimin Europian. Ne kemi patur dhe kemi në vazhdimësi një bashkëpunim të shkëlqyer me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, ku në këtë projekt-ligj kemi reflektuar të gjitha Direktivat dhe Rregulloret për gazin në përputhje me legjislacionin Europian, por gjithashtu kemi bërë edhe ndryshime që kanë të bëjnë me aplikimin e tyre në kushtet e vendit tonë, keto ndryshime mund të konsiderohen esenciale në krahasim me ligjin ekzistues të gazit, por jemi të bindur se po bëjme atë që kërkohet.

Ndër ndryshimet e tjera në përputhje me paketën e tretë të energjisë, mund të përmendim; Mbikqyrja dhe Inspektimi i tregut të gazit, parashikim i ndërtimit të rregulloreve për depozitimin e gazit natyror dhe gazit të lëngëzuar, janë përcaktuar afate për përgatitjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij projekt-ligji (nga ana e KM, Ministria, ERE dhe ndonjë institucion tjetër) si dhe shumë aspekte të tjera ligjore të cilat garantojnë një konkurrencë të tregut në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë.

Në keto kushte kërkohet kalimi në Parlament sa më shpejt të jetë e mundur e Ligjit të Ri të Gazit, sepse jemi shumë të vonuar në nxjerrjen e akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara nga Sekretariati i Energjisë, mbasi të gjithë fqinjët tanë e kanë kaluar tashmë në Parlamentet e tyre, dhe janë të gatshëm për aplikimin e Paketës së tretë të Energjisë në janar 2015.

Dhe konkretisht ne duhet të përfundojmë:

- Modelin e tregut të gazit;
- Hapjen e tregut të gazit, shpërbërjen e kompanise së integruar Albpetrol, e cila është edhe prodhuese, transmetuese edhe shpërndarëse;
- Rregullat e tregut;
- Kodin e transmetimit dhe kodin e shpërndarjes;
- Infrastrukturen e brendshme në përputhje me paketën e tretë;
- Metodologjinë e tarifave;
- Metodologjinë për alokimin e kapaciteteve;
- Udhëzuesin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, balancimin e tregut etj.

### 6.3.2 Miratimi i Metodologjisë së Tarifave të Gazit Natyror

Enti Rregullator i Energjisë miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013, “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

Në datën 8 Nëntor 2013, tre Rregullatorët e Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (Aeeg) aprovuan Kodin e Tarifave të propozuar nga kompania TAP AG për TAP, tubacionin e gazit që do të sjellë gazin e Azerbajxhanit në Itali, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Kodi i Tarifave për Gazin përshkruan metodologjitë e përdorura për përcaktimin e termave dhe kushteve të cmimeve që do të aplikohen për transportuesit e ardhshëm të gazit që do të transportojnë gazin nëpërmjet TAP dhe do të aplikohen si për kapacitetet subjekt i aksesit të detyrueshëm të paleve të treta, edhe për kapacitetet e përjashtuara nga këto kërkesa.

Metodologjia e tarifave e propozuar nga TAP AG është transparente, jo diskriminuese dhe me kosto efikente. Kodi i Tarifave parashikon një zvogelim të tarifës në rast të rritjes së kapacitetit të rezervuar në të ardhmen. Nga ana tjetër, në përputhje me Opinionin Final të Përbashkët, struktura e tarifave merr në konsideratë nivelin e ndryshëm të rrishtit ndërmjet investimit në kapacitetin fillestar dhe investimit për zgjerim në të ardhmen.

TAP ka paraqitur për shqyrtim, komente e sugjerime pranë tre autoriteteve rregullatore draftin e parë të metodologjisë së tarifave të TAP (TAP Tariff Code) që në datën 24.04.2013.

Drafti i Metodologjisë së Tarifave ka qenë objekt i një sërë takimesh, diskutimesh, conference calls dhe shkembimi komentesh ndërmjet të tre rregullatorëve, si dhe ndërmjet rregullatorëve dhe TAP. Duke qenë se tarifatat e transmetimit janë gjithashtu edhe objekt i Marrëveshjeve të Transportimit të Gazit të nënshkruara ndërmjet TAP dhe transportuesve të gazit (shippers), të cilët në pjesën e kapaciteteve fillestare objekt i Vendimit të Perjashtimit do të transportojnë gazin e aksionerëve të Konsorciumit Shah Deniz 2, Metodologjia e Tarifave është pjesë përberëse e këtyre Marrëveshjeve. Për pasojë në diskutimin e një sërë çështjesh së Metodologjisë së Tarifave ka patur edhe pjesëmarrje të perfaqësuesve të Konsorciumit Shah Deniz 2. Metodologjia e Tarifave ka pësuar një sërë ndryshimesh që prej versionit të saj fillestar në sajë të komenteve të bëra prej të tre Rregullatorëve në mënyrë që dokumenti të reflektojë parimet bazë të përmendura në Final Joint Opinion. Versioni përfundimtar i metodologjisë së Tarifave është paraqitur në ERE për miratim në datën 14 tetor 2013. Në përmbajtjen e kësaj metodologjie zbatohen kërkesat themelore të përcaktuara në Opinionin e Përbashkët në lidhje me tarifatat; reflektimi në tarifë i kostove efikase, që ato të jenë transparente dhe jo diskriminuese; mekanizmi që tarifatat të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren; marrja në konsideratë e nivelit të ndryshëm të rrishtit të investimit fillestar

dhe zgjerimit të mëtejshëm; tarifa të njëjta për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesit i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar.

## 6.4 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Enti Rregullator i Energjisë ka një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha organizatat dhe institucionet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me elektricitetin dhe gazin, pra me energjinë. Ndër këto organizata mund të përmendim: MEDREG (Mediterranean Energy Regulators) Regullatorët e Energjisë së Mesdheut, ku bëjnë pjesë:

- Vendet aëtare te BE: Itali, France, Greqi, Slloveni, Spanje ,Portugali,Kroaci dhe Qipro.
- Vendet kandidate apo perspektive për anëtare të EU: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali Zi dhe Turqia. Kosova ende nuk ka aderuar ne këtë institucion.
- Vendet partnere dhe shume aktive të mesdheut: Algjeri, Egjypt, Izrael, jordani, Marok dhe Tunizia.
- Vendet që kanë shprehur interes të cilat ndodhen në rajon dhe kanë një bashkëpunim: Liban, Libia dhe Siria.

Në kuadrin e bashkëpunimit shumë-palësh mes Enteve Rregullatore anëtarë të MEDREG (Mediterranean Regulators) ku vendi ynë është shumë aktiv, Asambleja e Përgjithshme ka zgjedhur Kryetarin e ERE-s Z.Petrit AHMETI në postin e Zëvendës Presidentit, si dhe Komisionerin e Hidrokarbureve në Bordin e ERE-s Z.Maksim SHULLI, në postin e Zëvendës Kryetarit në Grupin e Punës së Gazit. (<http://www.medreg-regulators.org>).

Njëkohësisht Enti Rregullator i Energjisë është shume aktiv edhe në ECRB (Energy Community Regulatory Board) dhe në Sekretariatit e Komunitetit të Energjise. Ai është pjesmarrës aktiv në ACER (Agency for the Cooperation of Energy Regulators) Agjensinë për Kooperim të Regulateve të Energjisë, si dhe në shumë organizma të tjera ku janë antarë aktiv të grupeve të punës si komisionerët edhe stafi i ERE-s. Ndër këto institucione mund të përmendim: IGU( Internacional Gas Union), E-CONTROL, EnC (Energy Community), SCE (Secretariat Community Energy) etj.

Për sa i takon bashkëpunimit mes Enteve Rregullatore Shqiptare, Italiane dhe Greke, Komisioni European ne Bruksel, më datë 13.10.2014 në raportin final të tij “*Progress Towards Completing the Internal Energy Market*”, shpreh në mënyrë eksplicite, se bashkëpunimi i të treja agjensive shtetërore është një shëmbull efektiv në vendosjen e një kuadri të përshtatshëm rregullator për TAP, i cili do të sjellë burime shtesë të gazit nga rajoni i Kaspikut në tregun e BE.

Gjithashtu edhe në raportin e ekspertëve të Komisionit Evropian “Raporti mbi Entin Rregullator të Energjisë -Raporti i Komisionin Evropian mbi Misionin e Ekspertëve për Institucionet e pavarura në Shqipëri / *Report on the Energy Regulatory - Report to the European Commission on the Peer Assessment of Independent Institutions in Albania*” shprehet se:

*“Personeli i ERE-es duhet të shtohet që institucioni të kryejë detyrat e tij në një mënyre të kënaqshme, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar kryerjen e të gjitha detyrave që dalin nga paketa e tretë e energjisë, dhe nevojën për të siguruar një performancë të detyrave që kanë të bëjnë me sektorin e gazit”.*

Për më tepër, në vazhdimësi të Raportit, përmendet nevoja e një personeli prej të paktën 10 persona që të punësohen për të siguruar kryerjen e detyrave që kanë lidhje me sektorin e gazit.



## **AKTIVITETI I ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË**

### **7.1 Aktiviteti i ERE-s në fushën e rregullimit të Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike**

#### **7.1.1 Rishikimi i Tarifave**

Bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), përkatësisht në nenet 26, 27 dhe 28 si dhe akteve të tjera nënligjore, që burojnë prej tij, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të aktiviteteve të rregulluara që realizohen në sektorin e energjise.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, një nga veprimtaritë kryesore të ERE-s gjatë vitit 2014 ishte shqyrtimi i aplikimeve për tarifatat dhe çmimet e reja nga ana e të licensuarve në sektorin elektroenergjetik përfshirë veprimtarinë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike për klientet tariforë.

Pas paraqitjes së Kërkeses për të Ardhura për vitin 2015 nga ana e shoqërive të rregulluara KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE.sh.a., ERE kreu një analizë të

treguesve teknik, ekonomik dhe financiar për periudhën 2012-2014. Rishikimi i tarifave u realizua në kushtet e:

- Pezullimit në vitet 2013-2014 të rishikimit të të ardhurave të kërkuara të kompanive publike (KESH sh.a, OST sh.a, OSHEE sh.a) për shkak të operimit në treg të aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë nën statusin e administrimit të përkohshëm. Në fillim të vitit 2013, ERE i hoqi kompanisë CEZ shpërndarje sh.a. liçencën për veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe liçencën për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, për shkak të performancës së dobët dhe rrjedhimisht mospërmbushjes së kushteve të liçencës. ERE, konform kompetencave që i jep ligji, emëroi një administrator të përkohshëm që të mbikëqyrë ose të operojë pajisjet dhe pasuritë sipas liçencës. Ky zhvillim bëri të pamundur zbatimin e mëtejshëm të përcaktimeve të Deklaratës Rregullatore të miratuar prej saj dhe kushtezoi vendimmarrjen e ERE-s sa i takon nivelit dhe strukturës së tarifave për vitet kalendarike 2013 dhe 2014, duke ruajtur Status Quo – në e përcaktuar për Periudhën e Tretë Rregullatore 2012-2014.
- Zgjidhjes me mirëkuptim në korrik 2014 të problemit të kontrollit të pronësisë mbi aksionet e CEZ Shpërndarje sh.a. ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A. S. Sipas kësaj Marrëveshjeje aksionet e CEZ Shpërndarje sh.a. i kaluan në pronësi shtetit shqiptar. Aktualisht shteti shqiptar zotëron 100 % të aksioneve të kësaj kompanie. Në këto kushte përfundoi periudha e administrimit të përkohshëm dhe kompania e licensuar për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes, si dhe aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike me emrin e ri OSHEE sh.a., i rifitoi liçencat duke kthyer normalitetin juridiko-institucional në sektorin elektroenergjetik shqiptar.
- Gjendjes tepër të vështirë financiare të trashëguar në sistemin energjetik si pasojë e performancës së dobët të kompanisë që ushtronte aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë gjatë viteve 2011-2012, e cila u reflektua drejtpërsëdrejti në aktivitetin e dy operatoreve të tjerë KESH sh.a dhe OST sh.a. Nga analiza e pasqyrave financiare të vitit 2014 të të tre kompanive publike, u konstatua se detyrimet e ndërsjellta të palëve ishin në shifra të konsiderueshme, (siç pasqyrohen në tabelat më poshtë.) Për këtë arsye ERE llogariti tarifën dhe çmimet për vitin 2015 për çdo kompani duke u bazuar tek metodologjitë përkatëse, por duke mos marrë parasysh axhustimet e periudhës 2012-2014, si pasojë e detyrimeve të ndërsjellta.
- Këto detyrime të ndërsjellta priten të jenë subjekt i një iniciative ligjore gjatë vitit 2015 për strukturimin e tyre (referuar komunikimit zyrtar të MEI-it me ERE-n). Gjithashtu mosmarrja parasysh e axhustimeve të periudhës 2012-2014 është mbështetur edhe në opinionin e konsulentit të USAID-it të dhenë ERE-s.

- Paraqitjes në afate kohore të ndryshme të aplikimeve nga të tre operatorët, veçanërisht ardhja me vonesë e aplikimit të OSHEE sh.a (13.11.2014) gjë që zvogëloi ndjeshëm kohën në dispozicion të ERE-s për shqyrtimin e aplikimeve dhe marjen e vendimit.
- Mos paraqitjes të aplikimit nga kompania TEC Vlore sh.a si pasojë e mos vënies në operim për shkak të defektit teknik.

Tabela në vijim paraqet një pasqyrë të detyrimeve aktuale të palëve më 31.12.2014 si dhe të situatës së këtyre kompanive në rast të shuarjes së detyrimeve reciproke.

**Tabela 7-1** Detyrimet aktuale të palëve më 31.12.2014

Bilanci i kombimuar i Sektorit Elektrik Shqiptar					Bilanci i Sektorit qe do te rezultonte mbas azhustimeve per detyrimet e OSHEE sh.a. ndaj KESH sh.a./OST sh.a.			
	(000 Lek)				(000 Lek)			
	KESH sh.a.	OST sh.a.	OSHEE sh.a.	Total	KESH sh.a.	OST sh.a.	OSHEE sh.a.	Total
Detyrime afatgjata	35,277,410	24,548,000	8,607,308	68,432,718	35,277,410	24,548,000	8,607,308	68,432,718
Detyrime afatshkurtra	71,981,349	3,646,000	95,196,153	170,823,502	71,981,349	3,646,000	32,311,519	107,938,868
Detyrimet totale	107,258,759	28,194,000	103,803,461	239,256,220	107,258,759	28,194,000	40,918,827	176,371,586
Asetet	187,006,408	53,216,000	33,161,915	273,384,323	133,413,077	43,924,697	33,161,915	210,499,689
Kapitali	79,747,648	25,022,000	(70,641,546)	34,128,102	26,154,317	15,730,697	(7,756,912)	34,128,102
							62,884,634	62,884,634

Shenim: Detyrimi i OSHEE sh.a. ndaj KESH sh.a. 53,593,331 mije leke dhe ndaj OST sh.a. 9,291,303 mije leke  
Per shumen e tyre prej 62,884,634 mije leke pakesohen detyrimet afatshkurtra te OSHEE sh.a.

Mbi bazë të kësaj analize dhe nëpërmjet një procesi tejet transparent në zbatim të Vendimit nr. 21.datë 18.03.2009 te Bordit të Komisionerëve të ERE-s i ndryshuar me vendimin Nr. 107 datë 17.10.2011, për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregullat e praktikës dhe procedurave te ERE-s” i cili përcakton etapat dhe procedurat përmes të cilave kryhet procesi i aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit të tarifave të energjisë elektrike si dhe në zbatim të metodologjive përkatëse, ERE miratoi tarifat dhe çmimet për veprimtaritë e mësipërme për vitin 2015 me vendimet Nr. 139, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 147, dhe 148 datë 26.12.2014.

### 7.1.2 Tarifat e prodhimit të energjisë elektrike për KESH sh.a.

Më 31 tetor 2014, KESH sh.a, i liçensuar për prodhimin e energjisë elektrike, paraqiti pranë Entit Rregullator të Energjisë aplikimin për rishikimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2015.

Si rezultat i seancave teknike dhe i komunikimeve intensive me kompaninë në lidhje me treguesit e paraqitur, KESH sh.a në datën 22.12.2014 paraqiti aplikimin



përfundimtar sipas të cilit tarifa për vitin 2015 e propozuar për prodhimin e energjisë elektrike ishte 1.44 lekë/kWh pra me një rritje prej 44% nga tarifa e mëparshme e periudhës 2012-2014.

Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike e miratuar për vitin 2015 bazohet në të Ardhurat e Kërkuara për një aktivitet normal për këtë periudhë, si dhe në axhustim të pjesshëm të periudhës së mëparshme rregullatore 2012-2014. Të ardhurat vjetore të kërkuara nga kompania për të mbuluar shpenzimet operative dhe ato kapitale u llogaritën në shumën 4,993 milion lekë nga 4,941 milion lekë të kërkuara nga kompania. Ky ndryshim në kërkesën për të ardhura vjen për shkak të korrigjimeve nga ERE në lidhje me saktësimin e llogaritjes së Bazës së Rregulluar të Aseteve, si dhe llogaritjes së fitimit të lejuar në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifave për kompanine publike të prodhimit.

Duke konsideruar që energjia elektrike e parashikuar për t'u prodhuar për vitin 2015 është 3,434 GWh, tarifa vjetore e Prodhimit Publik për vitin 2015 u miratua 1.45 lekë/kWh (Vendimin Nr. 139, Datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s), me një rritje prej 45% krahasuar me atë të periudhës 2012-2014. Tarifa e miratuar i mundëson një situatë financiare normale për realizimin e aktivitetit dhe arritjen e objektivave ekonomike nga ana e Shoqërisë Publike të Prodhimit ( KESH sh.a ).

### **7.1.3 Tarifa e Furnizimit Publik me Shumicë të energjisë elektrike**

KESH sh.a, i licencuar për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, aplikoi në Entin Rregullator të Energjisë kërkesën për rishikimin e tarifës së shërbimit të shitjes me shumicë të energjisë elektrike për vitin 2015, me anë të të cilit kërkoi një tarifë mesatare vjetore prej 3.45 lekë/kWh nga 2.2 lekë/kWh me një rritje prej 56 %.

Për llogaritjen e tarifës së Furnizuesit Publik me Shumicë, fillimisht u përcaktuan të ardhurat e kërkuara të KESH sh.a, në funksionin e tij si furnizues me shumicë i energjisë elektrike. Kjo llogaritje u bazua në:

Kërkesën për blerje energjie të barabartë me atë të kërkuar nga OSHEE sh.a. si furnizues me pakicë që për vitin 2015 parashikohet të jetë 4,544 GWh.

OPEX-et për realizimin e aktivitetit të furnizimit me shumicë në vlerën 1,813 milion lekë.

Për sa më lart, të ardhurat e miratuara nga ERE për vitin 2015 për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë u pranuan në shumën 13,632 milion lekë nga 15,697 milion lekë të kërkuara nga kompania. Ky ndryshim në të ardhurat e kërkuara erdhi kryesisht nga:

Rillogaritja e tarifës së blerjes së energjisë nga Prodhuesit e Vegjel të Energjisë në zbatim të VKM të datës 26.11.2014, "Për disa ndryshime në vendimin Nr.27, datë

19.01.2007, të Këshillit të Ministrave, " Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçensioneve" të ndryshuar .

Reflektimi ne llogaritje i tarifës për blerjen e energjisë nga KESH/Gen të miratuar nga ERE për vitin 2015 më e lartë nga ajo e parashikuar nga kompania (1.45 leke/kWh nga 1.44 leke/kWh).

Enti Rregullator i Energjisë me Vendimin Nr. 140 Datë 26.12.2014, miratoi tarifën prej 3.00 lekë/kWh për furnizuesin publik me shumicë. Tarifa për shërbimin e furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike për vitin 2015 është 36 % më e lartë nga tarifa e periudhës 2012-2014.

#### **7.1.4 Llogaritja e tarifës mesatare për shërbimet ndihmëse**

Enti Rregullator i Energjisë, në kuadër të zbatimit të detyrimit ligjor dhe rritjes së transparencës për alokimin e kostove në të gjithë hallkat e sektorit, për herë të parë bëri përpjekjen për të trajtuar edhe koston e shërbimeve ndihmëse e rrjedhimisht edhe për caktimin e tarifës përkatëse. Bazuar edhe në aplikimin e KESH sh.a. për tarifën e këtij shërbimi, ERE llogariti dhe miratoi tarifën për shërbimet ndihmëse, të cilat përfaqësojnë shërbime të kontrollit të kapaciteteve gjeneruese në kohë reale që sistemi i përdor për të ruajtur balancën e kërkuar ndërmjet ngarkesës dhe prodhimit të përgjithshëm. Miratimi i kësaj tarife u konsiderua si hap i nevojshëm në drejtim të riorganizimit të sistemit elektroenergjetik.

Llogjika e përlllogaritjes së tarifës së shërbimeve ndihmëse ka në themel alokimin e kostove fikse vjetore të KESH Gen për kapacitetin e rezervuar për shërbimet ndihmëse (rezerva sekondare dhe terciare).


Tarifa mesatare e miratuar nga ERE për shërbimet ndihmëse për vitin 2015 rezultoi 158 leke /MWh. Aplikimi i kësaj tarife do të jetë objekt testimi brenda tremujorit të parë të vitit 2015 në mënyrë që të rishikohet saktësia e llogaritjes midis palëve: KESH sh.a. dhe OST sh.a.

#### **7.1.5 Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et ekzistues dhe HEC-et e rinj me fuqi të instaluar 15 MW**

Gjatë vitit 2014 kanë hyrë për herë të parë në operim gjithsej 14 centrale me fuqi totale të impianteve gjeneruese prej 37.9 MW. Prodhimi i realizuar nga këto shoqëri gjatë 2014 ishte rreth 39.6 GWh, duke përfshirë edhe prodhimin prej 201 GWh të HEC Ashta, totali i energjisë që KESH sh.a. (në funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë) ka blere nga PVE dhe HEC Ashta për vitin 2014 arriti në rreth 919 GWh nga 280 GWh të miratuara për tarifën e furnizimit publik më shumicë të vitit 2014. Gjithashtu edhe çmimi mesatar i realizuar në fakt për këtë kategori prodhuesish është 9.02 leke/kWh nga 8.2 lekë/kWh të parashikuar në tarifë për vitin 2014. (Kjo për


shkak të rritjes së sasisë së prodhuar nga HEC-et e reja me konçension që kanë çmim të shitjes së energjisë më të lartë).


Grafiku në vijim paraqet ecurinë e energjisë së prodhuar nga PVE-të dhe HEC Ashta në vite.



**Figure 7-1** Ecuria e Prodhimit nga PVE-të dhe Ashta

Në vitin 2014, të ardhurat e realizuara nga PVE-të për energjinë e shitur tek FPSH kapën shifrën prej 8,138 milion lekë nga 2,296 milion lekë të parashikuara në tarifën e Furnizuesit Publik me Shumicë për vitin 2014. Kjo shifër përbën rreth 51% të kostos faktike nga 16.45% të pranuar në të ardhurat e kërkuara për FPSH në tarifën për vitin 2014. Grafiku në vijim paraqet strukturën faktike të kostove të KESH sh.a. në funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë për vitin 2014.



**Figure 7-2** Struktura faktike e kostove të KESH sh.a. si F.P.Sh. për vitin 2014*(Burimi i te dhenave KESH,ERE)***Figure 7-3** Të ardhurat nga HEC-et e Vegjël dhe HEC Ashta

Sfidë në të ardhmen mbetet gjetja e një zgjidhje të përshtashme për nxitjen e investimeve në drejtim të burimeve të rinovueshme të energjisë me qëllim të ndikimit sa më minimal në tarifën për konsumatorët fundorë.

### 7.1.6 Mbi rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-et ekzistues dhe HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2013 dhe 2014.

Për shkak se në vitin 2013 CEZ Shpërndarje sh.a. kaloi në kushtet e statusit juridik të një shoqërie në administrim të përkohshëm, ERE me Vendimet nr. 161 datë 07.12.2012, nr. 54 datë 03.05.2013, e më pas Vendimin nr. 149 datë 24.12.2013 la në fuqi përkatësisht deri në datë 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2014, tarifën e miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr 149 dhe 150 të datës 07.12.2011 për periudhën 2012-2014.


Vendimet e sipërpërmendura përcaktojnë se kompensimi i të gjitha efekteve financiare për operatorët e rregulluar do të kryhej brenda të njëjtës periudhë rregullatore 2012-2014, apo në periudhën rregullatore pasardhëse.

ERE në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr 149 dt 24.12.2013, gjeti detyrimin ligjor dhe bëri llogaritjet mbi efektin financiar dhe përcaktimin e tarifës së shitjes së energjisë elektrike për vitet 2013 dhe 2014 nga këta prodhues të vegjël të energjisë tek Furnizuesi Publik me Shumicë, bazuar në treguesit faktikë të realizuar të elementeve përbërëse të formulave për llogaritje të çmimit .

Çmimi i rishikuar i shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW rezultoi i njëjtë 7.53 leke/kWh për të dy vitet 2013 dhe

2014 dhe u miratua me Vendimin Nr. 143 dt 26.12.2014. Ndërsa çmimi i rishikuar i shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW rezultoi 9.73 lekë/kWh për vitin 2013 dhe 7.95 lekë/kWh për vitin 2014 dhe u miratuan me Vendimin Nr. 144 dt 26.12.2014.

Tabela në vijim paraqet çmimin e shitjes së energjisë elektrike të miratuar nga ERE për këta prodhues për periudhën 2004-2015. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga këta prodhues janë përcaktuar në përputhje me Metodologjinë e llogaritjes së çmimit unik për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë me Vendimin nr.24, date 11/04/ 2007 dhe Metodologjinë e llogaritjes të çmimit unik për prodhuesit me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të licencuar nga ERE për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë me Vendimin nr.5, date. 26/01/ 2007



Në lidhje me përditësimin e shpjeguar më sipër, PVE –të kanë ankumuar vendimin e ERE-s nr. 143 dhe 144 të dates 26.12.2014 në Gjykatën Administrative, duke pretenduar lënien në fuqi të çmimit të aplikuar prej 9.3 leke/kWh dhe 7.77 leke/kWh, çmime të miratuara nga ERE për vitin 2012, çka do të çonte në mos korrigjim të çmimeve të energjisë elektrike për periudhën përkatëse (2013-2014).

### **7.1.7 Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për HEC-et ekzistues dhe HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2015**

Në zbatim të kërkesave të ligjit 138/2013 ‘ Për burimet e rinovueshme’, ERE punoi në lidhje me përcaktimin e tarifës fikse të centraleve prodhuese që kanë përparësi,

nëpërmjet mbledhjes së të dhënave mbi tregues të ndryshëm teknik, ekonomik e financiar të shoqërive të liçencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga këto centrale.

Mbi bazën e informacionit të grumbulluar u ndërtua data baza përkatëse ku u regjistruan kompanitë dhe centralet prodhuese që ato disponojnë, duke i klasifikuar në tre grupe sipas fuqisë së instaluar siç përcaktohen në Ligjin e Burimeve të Rinovueshme. Konkretisht, në grupin e parë u përfshinë prodhuesit me fuqi nga 0-2000 kW, në grupin e dytë 2001- 5000 kW dhe në grupin e tretë ata me fuqi në kufijtë 5001-15000 kW, ku çdo shoqëri konsiderohet si një prodhues i vetëm pavarësisht numrit të centraleve që ajo ka në pronësi, pavarësisht nëse janë në formë kaskade apo të vendosur në zona të ndryshme të territorit të Shqipërisë.

Përgjatë procesit të përpunimit të informacionit të grumbulluar për efekt të llogaritjes së tarifave fikse u paraqitën probleme në lidhje me përcaktimin e subjekteve të cilave duhet t'u adresohet kjo metodologji, si dhe problematika që konstatohen në llogaritjet e tarifës fikse për çdo grup, si pasojë e futjes në operim në mënyrë të vazhdueshme të HEC-ve që janë në pronësi të një kompanie.

Nisur nga këto shqetësime, Ligji nr 26/2014 “Për disa ndryshime në Ligjin 138/2013” vendosi për shtyrjen e afateve të hartimit të akteve nënligjore deri më 01.01.2015.

ERE në mbledhjen e datës 26.12.2014, referuar shkresës së MEI-së nr. 7291/3 prot, datë 26.12.2014, në lidhje me kërkesën për shtyrjen e vendimmarrjes mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion me kapacitet të instaluar deri në 15 MW, vendosi të shtyjë këtë vendimmarrje.

Së fundmi VKM nr 125, datë 11.02.2015 ka miratuar metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'i paguhen prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike nga hidrocentralet.

Referuar këtij vendimi tarifat fikse të energjisë elektrike, që do t'u paguhen prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike nga hidrocentralet përcaktohet nga: çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike, norma mesatare e këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit dhe koeficienti 1.24, i cili merr në konsideratë faktorë të tillë si reduktimi i humbjeve teknike në rrjet, kostot e shmangura të alokimit të kapaciteteve dhe transmetimit të energjisë, etj.

Në zbatim të VKM nr. 125, datë 11.02.2015, Bordi i Komisionerëve të ERE-s miratoi me vendimin nr.27 datë 16.02.2015 një tarifë fikse prej 7.636 lekë/kWh që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet e vegjël për vitin 2015.

### **7.1.8 Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a.**

Operatori i Sistemit të Transmetimit, i licënsuar për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike, aplikoi në ERE për një rritje prej 11.2% të tarifës së transmetimit për vitin 2015 krahasuar me tarifën aktuale prej 0.65 lekë/kWh.

ERE në llogaritjen e tarifës së transmetimit është mbështetur në metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin Nr. 59, datë 29.12.2005, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Në zbatim të metodologjisë së sipërpërmendur dhe mbi bazën e një analize të hollësishme të pasqyrave financiare të OST për vitet 2007-2013, si dhe të informacionit të paraqitur në aplikim e më pas nga përgjigjet e pyetjeve shtesë të dërguara kompanisë dhe të parashtruara në seancat degjimore teknike, tarifa e transmetimit për vitin 2015 rezultoi 0.65 leke /kWh. Kjo tarifë është rezultat i të ardhurave të kërkuara prej 4,095 milion lekë dhe energjisë elektrike për t'u lëvruar në rrjetin e transmetimit të jetë 6,288 GWh.

Të ardhurat e kërkuara për vitin 2015 u miratuan më të ulëta nga sa aplikoi OST sh.a., për arsye kryesisht të reduktimit të të ardhurave të kërkuara për vitin 2015, me një pjesë nga të ardhurat e realizuara më tepër nga ato të miratura për vitin 2014 (900 milion lekë) nga alokimi i kapaciteteve, saktësimit të llogaritjes së fitimit të lejuar si dhe të parashikimit të energjisë për t'u lëvruar në rrjetin e transmetimit në vitin 2015, si pasojë e saktësimit të parashikimit të energjisë për tu transmetuar tek OSHEE sh.a.

Tarifa prej 0.65 lekë/kWh, u miratua me vendimin Nr.145, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

### **7.1.9 Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për OSHEE sh.a.**

Shoqëria OSHEE sh.a në funksionin e saj të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit publik me pakicë aplikoi pranë ERE-s për rishikimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes dhe të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015. Kërkesa e OSHEEsh.a. për tarifën e vitit 2015 lidhet me disa problematika ndër me kryesoret prej të cilave veçojmë:

- Ky rishikim erdhi pas një periudhe gati 2 vjecare gjatë të cilës kompanisë i ishte hequr licënsa, duke operuar në kushtet e administrimit të përkohëshëm e shoqëruar kjo me vendimmarrjen e ERE-s që linte në fuqi tarifën e miratuar me vendimet nr.147 dhe 148 datë 7.12.2011 për vitet 2013-2014.
- Kërkesa për rishikim bëhej edhe më e domosdoshme në kushtet e një situatë tejet kritike financiare të trashëguar nga administrimet e mëparshme.

Sipas këtij aplikimi fillestar kërkesa për të ardhura e kompanisë rezultonte në një tarifë mesatare për shpërndarjen e energjisë në rrjet prej 6.96 leke/kWh dhe çmim mesatar shitje të klientëve fundore prej 12.32 leke/kWh.

Puna për shqyrtimin, evidentimin dhe analizen e kërkesës për të ardhura të OSHEE sh.a. deri në miratimin e tarifave për vitin 2015 u krye përmes një procesi transparent në zbatim të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

Rezultat i këtij procesi ishte paraqitja nga ana e OSHEE sh.a. e aplikimit përfundimtar të datës 12.12.2014, i cili përmbante rillogaritjen e tarifave si pasojë e reflektimit të problematikave të dala në seancën teknike, planin e ndryshuar të investimeve, si dhe pritshmëritë më realiste të kompanisë për muajt Nëntor e Dhjetor 2014. Në këtë aplikim të ardhurat e kërkuara për të mbuluar aktivitetin e shpërndarjes dhe të furnizimit publik me pakicë u kërkuar në shumën 48,620 milion lekë për të realizuar shitjet tek konsumatorët tariforë për sasinë e energjisë elektrike prej 4,544 GWh, duke rezultuar në një tarifë mesatare të shpërndarjes në rrjet të energjisë prej 4.78 lekë/kWh dhe një çmim mesatar të shitjes tek klientët fundorë prej 10.7 leke/kWh.

Gjithashtu kompania propozoi edhe tarifa të diferencuara të shpërndarjes në rrjet të energjisë për nivele të ndryshme tensioni konkretisht 3.64 leke/kWh, 3.32 leke/kWh, 4.59 leke/kWh, 4.91 leke/kWh respektivisht për nivelet e tensionit 35 kV, 20 kV, 10-6 kV, TU.

Llogaritjet e kërkesës për të ardhura të kompanisë bazohen në parashikimin e saj mbi treguesit e bilancit energjetik, të parashikimit të sasisë së energjise elektrike të shitur tek klientët tariforë si dhe sasisë së energjisë për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.

Konkretisht, treguesit kryesorë të bilancit energjetik janë sasia e energjisë elektrike për shitje tek konsumatorët tariforë prej 4,544 GWh, dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve të energjisë në rrjet prej 1,211 GWh që përfaqesojnë në një nivel 21.04% ndaj sasisë totale të lëvruar në rrjetin e shpërndarjes.

Mbas një shqyrtimi të kujdesshëm të të gjithë elementëve përberës të kërkesës për të ardhura të kompanisë OSHEE sh.a, përfshirë edhe informacionet e sqarimet shitesë të marra nëpërmjet dokumentacionit plotësues, si dhe argumentimeve të bëra në seancat teknike të përbashkëta ERE vendosi t'i njohë OSHEE sh.a. për vitin 2015:

- Te ardhura vjetore në total për realizimin e veprimtarisë së Furnizuesit Publik me Pakicë shumën prej 48,641 milion lekë, duke përfshirë të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e gjenerimit, furnizimit me shumicë, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, ashtu siç paraqiten në grafikun e strukture së çmimit mesatar të shitjes me pakice të energjisë elektrike. Të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e furnizimit me pakice përfshijnë edhe detyrimin në shumën prej 3,433 milion lekë që rrjedh nga zbatimi i marrëveshjes së mirëkuptimit midis Qeverisë Shqiptare dhe CEZ a.s. të datës 23.06.2014 .



- Tarifë mesatare të shpërndarjes së energjisë për 4.79 lekë/kWh ose 4.2% më të ulët se tarifa mesatare vjetore e miratuar për periudhën rregullatore 2012-2014, që është rezultat i bashkëveprimit të faktorëve të ndryshëm të paraqitur në mënyrë analitike në relacionin përkatës. E rëndësishme të theksohet është mospërfshirja në tarifën e shpërndarjes të kostove të shkaktuara nga humbjet joteknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes.
- Cmim mesatar te shitjes me pakicë te energjise elektrike prej 10.7 lekë/kWh me një strukturë me të thjeshtuar të cmimeve te shitjes te energjise elektrike te konsumatorët tarifore.

Struktura e re e tarifave dhe cmimeve reflekton së pari heqjen e sistemit tarifor me dy blloqe për konsumatorët familjarë pasi aplikimi i sistemit dytarifor i projektuar më parë si një masë e efijences për energjinë kishte si qëllim dekurajimin e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje dhe konsumatorët t'i drejtoheshin burimeve të tjera të energjisë për këtë qëllim, nuk dha rezultatet e duhura. Ndërkohë aplikimi i tarifës me dy blloqe kishte rritur abuzimin nga ana e kompanisë, duke çuar në rritjen e numrit të ankesave nga familjarët për faturat e energjisë elektrike dhe ndërkohë pati ndikim të ndjeshëm në rritjen e nivelit të humbjeve joteknike të kompanisë. Perfundimisht u miratua një çmim i vetëm prej 9.5 leke/kWh për konsumatorët familjarë, pavarësisht sasisë së faturuar.

Struktura e re e tarifave së dyti realizoi reduktimin e grupeve të konsumatoreve të lidhur për çdo nivel tensioni si një hap i rëndësishëm drejt eliminimit të ndërsbvencionit midis kategorive të konsumatorëve në të njëjtin nivel tensioni. Në përcaktimin e këtyre çmimeve u siguria mbajtja e një tarife të pandryshuar për subjektet furra buke dhe prodhim mielli, duke mbajtur në këtë nivel shpenzimet e konsumatorit familjare për ushqimet bazë.


**Tabela 7-2** Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015

<b>Tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015</b>		
<b>Niveli i tensionit</b>	<b>Cmimi (leke/kWh)</b>	<b>Cmimi pik (leke/kWh)</b>
<b>Konsumatore në 35 kV</b>	<b>9.5</b>	<b>10.93</b>
<b>Konsumatore në 20/10/6 kV</b>	<b>11</b>	<b>12.65</b>
<b>Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV</b>	<b>7.1</b>	<b>8.17</b>
<b>Konsumatore në 0,4 kV</b>	<b>14</b>	<b>16.1</b>
<b>Furra buke dhe prodhim mielli në 0,4 kV</b>	<b>7.6</b>	<b>8.74</b>
<b>Familjare</b>	<b>9.5</b>	
<b>Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)</b>	<b>9.5</b>	
<b>Tarife fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)</b>	<b>200</b>	
<i>*Cmimi i energjisë reaktive është sa 15 % e cmimit të energjisë aktive</i>		
<i>* Orari pik gjate te cilit do te aplikohet tarifa per energjine e konsumuar ne pik është :</i>		
<i>Per periudhen 1 Nentor - 31 Mars nga ora 18:00 deri ne 22:00</i>		
<i>Per periudhen 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23 : 00</i>		

Tarifën për akses në rrjetin e shpërndarjes për nivelin e tensionit 35 kV prej 1.5 leke/kWh me Vendimin Nr.147, dt 26.12.2014 duke mundësuar kështu daljen në treg të hapur të konsumatorëve të lidhur në këtë nivel tensioni . Ky hap u ndërmor në zbatim të angazhimeve që vendi ka ndërmarrë në kuadër të implementimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë

Në përfundim të analizave dhe metodologjisë, ERE me Vendimin Nr. 148, datë 2014 miratoi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015 sipas tabelës në vijim.

Duhet theksuar se në përcaktimin e çmimeve si më lart, ERE bëri të gjitha përpjekjet për të vendosur ekuilibrat më të arsyeshme dhe të reflektohen zgjidhjet me optimale, në mënyrë që çmimet dhe tarifat e reja për vitin 2015, të sigurojnë mbrojtjen e konsumatorit përmes tarifave që reflektojnë kostot e drejta dhe të argumentuara për një shërbim furnizimi të energjisë elektrike të pandërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së furnizimit si dhe t'i krijojnë kompanive të rregulluara të ardhurat e nevojshme për një operim normal duke siguruar vazhdimësinë e tyre.



**Figure 7-4** Struktura e çmimit mesatar të shitjes me pakicë e miratuar nga ERE për 2014 dhe 2015

Rishikimi i çmimeve të shitjes së energjisë elektrike ka reflektuar zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fuqi, duke konsideruar interesat e konsumatorëve, kompanive dhe shtetit.

Grafiku i mësipërm paraqet strukturën e tarifave sipas Vendimeve të Bordit të Komisionerëve, Nr.139, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 147, dhe 148 datë 26.12.2014 si dhe sipas përlllogaritjeve të kryera në dhjetor 2012 për tarifat e vitit 2014.

Në grafikun e figurës në vijim është paraqitur ecuria e çmimeve të energjisë elektrike të miratuara nga ERE gjatë periudhës 2008-2015:




Figure 7-5 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2015

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë.





Figure 7-6 Çmimi mesatar i realizuar

(Burimi ERE, OSHEE)


### 7.1.10 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, viti 2014

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifën e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Evropës Qendrore / Lindore. Ajo përmban të dhënat tremujore nga viti 2000 deri më sot dhe mbulon 28 vende (Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Moldavia, Polonia, Rumania, Rusia, Turqia, Ukraina, etj).

Në grafikun e figurës 7-7 janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët jo familjarë, për vendet e ERRA-s, në Euro cent/kWh dhe leke/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jo familjarë për vendet e rajonit është 12.33 leke/kWh.



**Figure 7-7** Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve *jo familjarë* në vendet e rajonit (Burimi: ERA)



**Figure 7-8** Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit (Burimi: ERA)

Në grafikun e Figurës 7-8 janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, për të gjitha vendet e ERRA-s në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vendet e rajonit është 12.88 lekë/kWh.

### **7.1.11 Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2014**

Një pjesë e veprimtarisë së ERE-s është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë miratuar gjatë vitit 2014 apo janë ende në proces përpunimi nga ERE disa akte me mjaft rëndësi.

Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore nga ana e ERE-s, është bërë në çdo rast duke marrë parasysh së pari t'u krijojë palëve të interesit mundësi njohje me përmbajtjen e dokumenteve, mundësinë për dëgjimin e palëve të interesuara nëpërmjet dërgimit të opinioneve apo komenteve të ndryshme, apo edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentet në proces përpunimi nga ERE, të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen e elektronike të ERE-s. Nëpërmjet këtij procesi ERE ka synuar marrjen e komenteve dhe njohjen me këndvështrimin e palëve të treta për rregullimin e tregut të energjisë elektrike përmes akteve nënligjore që ERE miraton. Po ashtu edhe finalizimi i procesit garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun. Kuadri ligjor ka ende nevojë për zhvillim, e ligji i ri i sektorit të energjisë që pritet të miratohet së afërmi do të përmirësojë ndjeshëm menaxhimin e rrethanave të reja që kanë ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të tregut të energjitikës.

Në mënyrë më të detajuar gjatë vitit 2014, ERE ka miratuar si dhe ka në proces aktet rregullatore që vijojnë më poshtë të grupuara në:

- Aktet nënligjore të miratuara nga ERE, për sektorin e energjisë elektrike.
- Aktet nënligjore të miratuara nga ERE, për sektorin e gazit

Gjatë vitit 2014 ERE ka miratuar aktet nënligjore në vijim:

#### **1. Vendim Nr.9 Datë 06.02.2014 “Mbi një shtesë në Rregulloren mbi procedurat e emërimit të Administratorit dhe kompetencat e tij , në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit NR. 9072, datë 22.05.2003 “ Për sektorin e Energjisë Elektrike”.**

ERE me vendimin nr. 9, datë 06.02.2014, vendosi :

- Të shfuqizojë vendimin nr. 150, datë 30.12.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Mbi prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor.”
- Të shtojë në nenin 12 pika 4, të Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij në zbatim të nenit 18, pika 4 gërma “c”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, paragrafin me përmbajtjen si më poshtë : CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në

sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor. Për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes mbi baza mujore, Administratori zbaton Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 30, datë 23.03.2011, “Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të Blerjes së Energjisë Elektrike nga KESH sh.a”.

## **2. Vendim Nr. 155, Datë 29.12.2014 “Për Miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”**

Me datë 23.06.2008 me Vendimin nr. 68, Bordi i Komisionerëve miratoi Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike. Me Vendim Nr. 43, Datë 13.05.2014 u vendos që ky rregullim i shtrinte efektet deri në datën 31.12.2014. Vendosja e këtij afati u bë duke konsideruar që një përpunim i mëtejshëm i rregullave të balancimit të reflektonte realisht specifikat e tregut shqiptar dhe përafrimin me legjislacionin Evropian, në vlerësim të zhvillimeve të tregut në një kohë tjetër pas ndryshimeve të mundshme të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe si të tillë edhe në tregun e energjisë elektrike. Duke vlerësuar që Ligji i ri Për Sektorin e Energjisë Elektrike është në proces miratimi dhe si të tillë dizenjimi përkatës i detyrave dhe rolit të secilit operator në treg, do të kushtëzohet me përcaktimet e ligjit që pritet të miratohet, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbështetje të neneve 9 dhe 54, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendosi : Pika 1 e Vendimit Nr. 43 datë 13.05.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshohet si më poshtë: “Vendimi nr.93, date 16.07.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 31.03.2015”.

## **3. Vendim Nr.47, Datë 07.07.2014 “Për miratimin e pagesave të rregullimit për vitin 2014”**

Në zbatim të nenit 12 të Ligjit 9072 “ Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 48, datë. 07.07. 2014 “Për miratimin e Buxhetit të ERE-s për vitin 2014”, rezulton se vlera totale e shpenzimeve operative dhe për investime që shërbeu si bazë për llogaritjen e pagesave të rregullimit për vitin 2014 për të gjithë të licensuarit nga ERE është në shumën 121,503 mijë lekë. Duke ju referuar data –base të Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit rezultojnë 174 të licensuar nga ERE deri më 13.06.2014. Pagesat e rregullimit janë llogaritur bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i licensuar për secilin operator, ndaj totalit të të ardhurave të sistemit. Me këtë vendim janë miratuar “Pagesat e rregullimit për vitin 2014” sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.

## **4. Vendim Nr.61, Datë 07.07.2014 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa të rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve”**

Me iniciativë të shoqërisë OST sh.a, ERE shqyrtoi propozimin e OST sh.a. për një ndryshim në Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit “Mbi

realizimin e procedurave të ankandit ditor me anë të platformës elektronike “. Pas një analize të propozimit të bërë nga OST sh.a , ERE vendosi të miratojë ndryshimet e propozuara nga shoqëria OST sh.a. dhe t'i reflektoje ato të ndryshuara në “Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit”.

**5. Vendim Nr. 90, Datë 06.10.2014 “Mbi miratimin e transferimit të aksioneve të shoqërisë OSHEE sh.a. (njohur më parë si CEZ Shpërndarje), nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë informoi ERE-n, “Për nënshkrimin e marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s. ” e cila është miratuar me ligjin 114/ 2014, date 31.07.2014 dhe që tashmë ka hyre ne fuqi. Ne kete marrëveshje, ndërmjet te tjerave, ishin përcaktuar detyrimet e domosdoshme për finalizimin e kësaj marrëveshjeje, për tu kryer nga ana e institucioneve te shtetit Shqiptar për transferimin e aksioneve nga shoqëria CEZ a.s te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Në funksion të finalizimit të këtij procesi, si dhe referuar Aneksit 2, të kësaj marrëveshje, ishte i nevojshëm miratimi i marrëveshjes se transferimit te aksioneve nga Enti Rregullator i Energjisë si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet nënshkrimit kolegjal të vendimit të miratimit.

**6. Vendim Nr. 156, Datë 01.12.2014 “Mbi miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore (SEE CAO) ”**

Me iniciativë të OST sh.a e cila ka propozuar në ERE miratimin e Rregullave te Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore (SEE CAO), Enti Rregullator i Energjisë ka nisur procedurat e shqyrtimit e marrjes së opinionëve nga grupet e interesit. Nga ana e ERE është proceduar me botimin në gazetë të këtij propozimi, publikimi ne faqen e internetit te ERE-s për kërkesë opinionit dhe gjithashtu është dërguar kërkesa për mendim palëve të interesuara OSHEE sh.a., Autoritetit të Konkurrencës , Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë MEI si edhe Sekretariatit te Energjisë (Vjene, Austri).Rregullorja është e hartuar ne përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 te Parlamentit Evropian. Pjesëmarrësit e Tregut duhet të jenë regjistruar në SEE CAO si Pjesëmarrës Tregu duke plotësuar me sukses Deklaratën e Pranimit e cila është publikuar në faqen e internetit të SEE CAO. Rregullorja e Ankandit anulon dhe zëvendëson te gjitha rregullat e mëparshme te ankandit, te cilat me pare bënëin alokimin e kapacitetit ndërkufitar ne kombinime te caktuara dhe korniza kohore te përmendura.

**7. Aktet nënligjore të miratuara nga ERE, për sektorin e gazit**

Kuadri ligjor i miratuar në ERE në lidhje me Projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) ka pasur zhvillime të rëndësishme për vitin 2014

Gjatë vitit kalendarik 2014, në lidhje me projektin Trans Adriatic Pipeline, ERE në bashkëpunim me Entin Rregullator Italian (AEEGSI), si dhe atë Grek (RAE), në kuadër të Marrëveshjes "Joint Opinion of the Regulatory Energy Regulators

/Opinionini i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë Elektrike”, të nënshkruar mes të tre rregullatorëve me datë 28/02/2013, ka miratuar vendimet e mëposhtme:

- Në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009, si dhe Vendimit të Komisionit Evropian C (2013) 2949 të datë 16 Maj 2013, “Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC”, pas Kërkesës së paraqitur nga TAP AG në datën 5 shkurt 2014, për miratimin e draftit final të “Programit të Pëputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” i dorëzuar më parë në 15 Nëntor 2013, si dhe njëkohësisht drejtuar edhe Autoriteteve Rregullatore të Italisë (AEEGSI) dhe Greqisë (RAE), Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.02.2014 me Vendimin nr.12, Datë 14.02.2014 miratoi “Programin e Pëputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” në kuadër të Proçedurës së Përfundimit për Gazsjellësin TAP.
- Në zbatim të nenit 36, paragrafi i 6 i Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009, dhe “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” të miratuar nga Entet Rregullatore Shqiptare, Italiane dhe Greke, Bordi i Komisionerëve të ERE me Vendimin nr.16, date 13.03.2014 miratoi Udhëzuesin për Menaxhimin dhe Alokimin e Kapaciteteve në Projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) për Fazën e Parë të Rezervimit (First Booking Phase)” sipas “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” në Kuadër të Proçedurës së Përfundimit për Gazsjellësin TAP.
- Në zbatim të nenit 36, paragrafi i 6 i Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009, Bordi i Komisionerëve të ERE me Vendimin nr.17, datë 13.03.2014 miratoi “Njoftimin e Fazës së Rezervimit/Booking Phase Notice” paraqitur nga TAP AG për Proçedurën e Alokimit të Kapaciteteve të Gazsjellësit TAP në Përputhje me Udhëzuesin e Aprovuar me Vendimin nr.16, Datë 13.03.2014”.
- Në përputhje me dispozitat e nenit 36 të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 Korrik 2009, Bordi i Komisionerëve të ERE me Vendimin nr.135, datë 24.12.2014 miratoi “Energy Regulator’s Joint Opinion on TAP AG’s Request for a Prolongation of the Validity Period of the Exemption Decision/Opinion i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Kërkesën e TAP AG për Shtyrje të Periudhës së Vlefshmërisë të Vendimit të Përfundimit”.

## 8. Trajtimi i proçeseve gjyqësore

Gjatë vitit 2014, nga ERE janë ndjekur edhe një sërë çështjesh gjyqësore që kanë pasur zhvillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si edhe në Gjykatën Administrative.



Rezulton se numri i proceseve gjyqësore që ERE ka ndjekur gjatë vitit 2014 ka qenë më i madh se ai i një viti më pare.

Mosmarrëveshjet që janë trajtuar në këto gjykime kanë qënë kryesisht ankimime nga subjektet e licensuara nga ERE dhe ankesa të qytetarëve (konsumatorëve) për mbifaturim të energjisë elektrike, ku ERE është i thirrur si person i tretë.

Çështjet ku ERE ka qënë palë e paditur, respektivisht konsistojnë në:

- Ankimimi i OSHEE sh.a në lidhje me Vendimin nr. 108, datë 21.01.2011, “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Familjarë” dhe Vendimin nr. 109, datë 21.01.2011, “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Jo-Familjarë” – Aktualisht eshte në proces në Gjykatën e Apelit Administrativ;
- Ankimimi i OSHEE sh.a në lidhje me Vendimin nr. 31, datë 31.03.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesi Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011”- – Aktualisht eshte në proces në Gjykatën e Apelit Administrativ;
- Ankimimi i OSHEE sh.a në lidhje me Vendimin nr. 102, datë 19.07.2012, “Për miratimin e marrëveshjes së Transmetimit të Energjisë Elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, për pikën 15.3 të Marrëveshjes.”- Në shkallë të parë kjo çështje është fituar nga ana e ERE-s dhe eshte në proces në Gjykatën e Apelit Administrativ;
- Ankimimi i OSHEE sh.a në lidhje me “Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit nr. 62, datë 22.07.2011, “Për miratimin e Kontratës tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit periodik e fillestar të matësave të energjisë, si edhe Vendimit nr. 73, datë 09.08.2011, “Mbi ankimimin e CEZ Shpërndarje sh.a të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 62, datë 22.07.2011 “Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit periodik e fillestar të matësave të energjisë elektrike.” –e fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s dhe aktualisht eshte në proces në Gjykatën e Apelit Administrativ;
- Ankimimi i OSHEE sh.a në lidhje me “Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 128, datë 11.09.2011 “Për procedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë CEZ Shpërndarje”, “Deklarimi i pavlefshmërisë dhe anulimi i Vendimit nr. 128, datë 11.09.2011 “Për procedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë CEZ Shpërndarje” – e fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s dhe aktualisht eshte në proces ne Gjykatën e Apelit Administrativ
- Ankimimi i OSHEE sh.a në lidhje me “Anullim i pjesshëm i aktit administrativ te Vendimi i Bordit te Komisionerëve te ERE nr. 110, date 21.10.2011 “Për miratimin e rregullores për kushtet minimale te cilësisë se

shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, – Fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s dhe aktualisht në proces në Gjykatën e Apelit Administrativ;

- Ankimimi i KESH sh.a në lidhje me Vendimin e ERE-s nr. 118, datë 28.12.2010 “Për mospranimin e ankesës së KESH sh.a për rishikimin e Vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 97, datë 07.12.2010, “Për Përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011.”- E fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s, është ankimuar nga ana e KESH në Gjykatë të Apelit;
- Ankimimi i GEN – I Tirana sh.p.k në lidhje me Vendimin nr. 78, datë 22.10.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s - lidhur me miratimin e lidhjes së kontratave për shit – blerjen e energjisë për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011, midis shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a dhe shoqërive CEZ AS dhe EFT AG. Aktualisht është në Gjykatë të Lartë pasi pala paditëse ka ushtruar Rekurs;
- Ankimimi i “EMIKEL 2003” sh.p.k, me objekt “Anullimi i vendimeve 52 dhe 53 datë 03.05.2013, të ERE-s.” Çështja aktualisht është duke u gjykuar në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Ankimimi i “Projeksion Energji” sh.a me objekt: “Ndryshimin tërësisht të aktit administrativ dhe detyrimin e organit publik për të ndryshuar aktin administrativ nr. 26, datë 21.03.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Çështja aktualisht është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Albaco Shoes sh.p.k. dhe palë të paditur CEZ Shpërndarje sh.a, Enti Rregullator i Energjisë është palë e tretë në këtë proces gjyqësor me objekt padie “Detyrimin e të paditurit të paguajë shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë si rezultat i ndërprerjes së energjisë nga data 18 Qershor deri në datë 25 Qershor 2013 në shumën 150.000 Euro, ose ekuivalentin në lekë”. Aktualisht është duke u gjykuar në Gjykatën e shkallës së parë Tiranë;
- OSHEE sh.a dhe palë të paditur Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, për pavlefshmëri vendimi. Enti Rregullator i Energjisë është palë e tretë në këtë proces gjyqësor. Çështja aktualisht është duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- OSHEE sh.a. dhe palë të paditur Drejtoria e Përgjithëshme e Metrologjisë, ku Enti Rregullator i Energjisë është palë e tretë në çështjen civile me objekt: “Kundërshtimin dhe anulimin e vendimeve të inspektorëve meteorologë të Drejtorisë së Përgjithëshme të Meteorologjisë”. Fituar nga pala paditëse në shkallë të parë .
- Padi Konsumatorësh

Janë 5 procese gjyqësore, kryesisht të ngritura pranë gjykatave civile, me objekt padie kundërshtimin e gjobave, apo vendimeve të tjera të OSHEE, në të cilat ERE është thirrur në cilësinë e palës së tretë. Këto procese janë të gjitha të iniciuara gjatë vitit 2014 dhe aktualisht janë duke u shqyrtuar në Gjykatat e Shkallës së parë.

## **7.2 Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit**

Enti Rregullator i Energjisë, bazuar në Ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, ka ushtruar detyrën e tij në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, për të pasur tarifa që reflektojnë parimet e vendosjes së tarifave dhe kushteve të shërbimit, ashtu siç përcakton ligji dhe aktet nënligjore në fuqi. Mbrojtja e konsumatorëve është drejtuar edhe në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe të licencuarve, mbikëqyrjes dhe zbatimit nga kompania e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë dhe mbrojtjes të të drejtave të tyre. Puna e ERE-s në veprimtarinë e mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2014 kryesisht ka konsistuar në monitorimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të tilla si :Ligji Nr. 9072, date 22.05.2003 “ Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për konsumatorët Familjarë dhe Jofamiljarë ( etj).

Te dhenat e administruara pranë ERE-s tregojnë se numri i ankesave të konsumatorëve për vitin 2014 është i konsiderueshëm dhe relativisht më i lartë se në vitin 2013. Kështu në vitin 2013 janë trajtuar 1359, ankesa ndërsa për vitin 2014 janë trajtuar 2225 ankesa.

Për të qenë me afër konsumatorit ERE, e ka konsideruar detyrë të saj asistencën dhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve dhe konsultime verbale dhe me e-mail e telefon.

Ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike ka rritur ndjeshëm numrin e ankesave të trajtuara nga ERE.

Numri më i madh i ankesave ka konsistuar kryesisht në shkelje të kushteve të përgjithshme të kontratave të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët familjarë dhe jofamiljarë. Kontratat e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe Jo familjarë miratuar me Vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 108 dhe Nr. 109, date 21.10.2011 kanë të përcaktuara qartë raportet e detyrimeve reciproke të konsumatorëve të energjisë elektrike dhe kompanisë “OSHEE” sha, me cilësinë e furnizuesit publik me pakicë.

Për të mbikëqyrrur më mirë detyrimet që i atribuohen kompanisë, ERE në reference të Ligjit Nr .9072, datë 22.05.2003 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar,

dhe mbështetur në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e konsumatorëve, duke konstatuar se pjesa më e madhe e ankesave konsistojnë në shkeljen e afatit të trajtimit të tyre siç është përcaktuar në pikën 6.10 të licensës së “Furnizuesit Publik me Pakicë” dhe në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në pikën 12.2 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Familjarë dhe Jofamiljarë”.

Në tabelën Nr.7-9 jepet në mënyrë të detajuar totali i ankesave të trajtuara nga ERE të ndara sipas objektit.

**Figure 7-9** Totali i ankesave të paraqitura në ERE për vitin 2014

Objekti	Energji E pamatur	Dem Ekonomik	Faturim aforfe	Mbifaturim Keqfaturim	Faturim Fiktiv	Moskreditim Pagesash	Muk t	Kerkese per Lidhje te re	Te Ndryshme	Totali
Janar	49	20	13	54	8	7	13	4	15	183
Shkurt	50	21	0	30	6	5	6	2	3	123
Mars	31	11	14	17	12	6	16	5	4	116
Prill	67	11	19	62	14	3	10	1	3	190
Maj	34	0	8	29	21	3	1	1	5	102
Qershor	49	21	22	25	12	3	20	1	9	162
Korrik	25	11	14	30	5	3	32	0	4	124
Gusht	37	8	7	34	2	3	11	1	2	105
Shtator	30	14	14	36	7	5	24	0	5	135
Tetor	32	9	0	36	5	6	29	1	3	121
Nentor	81	13	69	58	22	12	32	1	15	303
Dhjetor	182	30	79	152	33	11	67	1	6	561
<b>Totali</b>	<b>667</b>	<b>169</b>	<b>259</b>	<b>563</b>	<b>147</b>	<b>67</b>	<b>261</b>	<b>18</b>	<b>74</b>	<b>2225</b>

Totali i ankesave të trajtuara nga ERE është 2,225 ankesa gjatë periudhës janar – dhjetor 2014.

Nga analizimi i të dhënave konstatohet se ankesat me objekt “energjinë e pamatur” zënë një vend të rëndësishëm në trajtimin e ankesave të ndjekura dhe nga ankesat me objekt keq-faturimin dhe mbi-faturimin.

Gjatë shqyrtimit të ankesave në dokumentacionin e paraqitur nga konsumatorët, është konstatuar se nga procesverbalet e lëshuara nga Shoqëria e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, pjesa më e madhe e tyre janë kryer jo në praninë e abonentit. Një procedurë e tillë bie ndesh me nenin 14.1 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jo-familjarë, si dhe me nenin III.7.7 të Kodit të Matjes.

Pjesa më e madhe e kontrolleve të ushtruara nga kompania ka konsistuar në bokse kolektive, të cilat janë në administrim të kompanisë. Sikurse më sipër paraqitur konstatohen rreth 667 ankesa për “energji të pamatur” dhe rreth 563 ankesa për mbi-faturim dhe keq-faturim të energjisë elektrike. Në mënyrë grafike ky informacion jepet në Figurën 7-10.

Në grafikun e Figurës 7-11 paraqiten në mënyrë analitike objektet e ankesave të trajtuara sipas muajve.




Figure 7-10 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë 2014




Figure 7-11 Ankesat e trajtuara sipas muajve, viti 2014

**Mbifaturimi dhe keqfaturimi i energjisë elektrike.** Në spektrin e ankesave një vend të konsiderueshëm zënë dhe ankesat në lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjisë elektrike që janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mos rakordimi i gjendjes së hedhur në sistem me gjendjen reale të matësit, gabime nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Këto problematika rrisin në mënyrë të konsiderueshme peshën financiare që iu ngarkohet abonentëve, duke ulur nivelin e arkëtimit. Te gjithë këta faktorë kanë sjellë që ankesat në lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjisë elektrike të jenë konsideruar si problematike edhe për vitin 2014. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga “OSHEE” sha, informacionin e nevojshëm dhe verifikimin në vend të tyre. Në këto kushte i janë dhënë udhëzimet përkatëse kompanisë “OSHEE” sha, duke i caktuar afate për zgjidhjen e tyre. Nga të dhënat e disponuara rezultojnë 536 ankesa mbifaturim dhe keqfaturim.

**Faturimet aforfe.** Ky fenomen është ndeshur ndjeshëm në trajtimin e ankesave të konsumatorëve, të cilët edhe pse kanë qenë me matës, përsëri janë faturuar aforfe në kundërshtim me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE –s Nr. 146, datë 24.12.2013 ”Mbi kërkesën e kompanisë “Cez-Shpërndarje” sha, në administrim të përkohshëm, për vendosjen e faturimit aforfe”. Sipas këtij vendimi “faturimi aforfe”

do të aplikohet për klientët familjare pa matës ose për konsumatorët me matës të demtuar dhe jashtë kushtit teknik. Faturimi do të aplikohet për një periudhë jo me shumë se 2 muaj”.

Gjatë vitit 2014 janë vendosur faturime aforfe jashtë tabelës së përcaktuar nga ERE dhe gjithashtu në rastet e matësve të demtuar janë konstatuar raste ku faturimi aforfe është aplikuar nga kompania për një periudhë më të madhe se dy muaj. ERE ka trajtuar rreth 259 ankesa me objekt faturimin aforfe.

**Ndërprerja e menjëhershme e energjisë elektrike.** Një shkelje tjetër është fakti që menjëherë pas vendosjes së “dëmit ekonomik”, abonentëve iu është bërë ndërprerja e menjëhershme e energjisë elektrike, duke i vënë përballë detyrimit të pagimit të vlerës së “dëmit ekonomik” pa e pasqyruar këtë vlerë në faturën përkatëse të energjisë elektrike, gjë e cila bie në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, konkretisht me nenin 11.1 të kësaj kontrate ku citohet se “Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas neneve 9.1 dhe 10, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga Klienti”. Në bazë të të dhënave që ERE disponon, janë trajtuar rreth 169 ankesa, për pjesën më të madhe të tyre nuk është kthyer përgjigje dhe nuk është bërë sistemimi përfundimtar i gjëndjes reale të leximit të matësit.

Edhe gjatë 2014 vazhdon të konstatohet se nuk është respektuar afati 30 ditor për leximin periodik të matësit. Ankesat që janë paraqitur në ERE dhe në lidhje me problemet e mbifaturimit dhe keqfaturimit të energjisë elektrike, të cilat vijnë si pasojë e mos leximeve periodike të matësve të energjisë elektrike për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike, detyrim ku i përcaktuar dhe në Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë, neni 7.1. Janë ndeshur gjithashtu faturime dukshëm të gabuara. Janë evidentuar faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mesatare mujore të konsumatorëve (të krahasueshme ose më shumë se trefishi i faturimit mesatar mujor). Kompania “OSHEE”sha, nuk ka zbatuar nenin 12.6 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, ku përcaktohet qartë se “Furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përshpejtuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.”

**Aksesi për leximin e matësve nga ana e konsumatorëve.** Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, neni 7.3 i saj përcakton se furnizuesi është i detyruar të sigurojë aksesin e Klientit për leximin e aparatit matës në çdo kohë”. Lidhur me këtë fakt, ERE ka vërejtur se kompania “OSHEE”sha, nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e nenit 7.3 të Kontratës.

**Kolaudimi i matësve të energjisë elektrike.** Kerkesat nga konsumatorët për kolaudimin e matësve për vitin 2014 në ERE, kanë qenë më pak në krahasim me

vitin 2013, (rreth 15 kërkesa). ERE i ka kërkuar kompanise së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike trajtimin e këtyre rasteve konform procedurave përkatëse.

**Cilësia e furnizimit me energji elektrike.** Problematike gjithashtu ka rezultuar edhe cilësia e tensionit të furnizimit me energji elektrike. Kjo problematikë është ndeshur më shumë në zonat rurale dhe tek subjekte të ndryshme private. Këto ankesa janë përcjellë në ERE në më të shumtën e rasteve nga MEI dhe Avokati i Popullit dhe institucione te tjere. Problemet me cilësinë e tensionit, janë të njohura dhe të pranuar nga “OSHEE”sha. Nga ana e ERE-s këto ankesa janë trajtuar, duke organizuar seancë dëgjimore, në të cilat i është kërkuar “OSHEE-se” të merret informacion i detajuar lidhur me shkaqet e ndërprerjeve dhe kohëzgjatjen e tyre.

**Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.** Problematike është paraqitur gjithashtu situata, e cila ka të bëjë me ndërrimin e matësive, të cilët janë jashtë kushtit teknik, brenda afateve të caktuara. Mosrespektimi i këtyre afateve ka sjellë ngarkimin e konsumatorëve me energji të faturuar për “matje jashtë kushteve teknike”, faturim i cili nuk është bërë në bazë të legjislacionit në fuqi. Kjo pasi në Kontratën për Furnizimin me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, në Nenin 8, pika 2, citohet se “nëse Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero”. Ankimet për këtë problematikë kanë qenë të ndjeshme rreth 261 ankesa.

**Kontrata fiktive.** Theksojmë faktin se vazhdon të ndeshen probleme lidhur me kontrata fiktive të hapura në mënyrë të njëanshme nga ana e kompanisë. Këto kontrata janë kryesisht të dubluara me kontratat origjinale të klientëve, ose janë kontrata të hapura në mënyrë të njëanshme pa marrëveshje mes palëve. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar rreth 147 ankesa të kësaj natyre.

**Mosrespektimi i afateve të përcaktuara për lidhjen e kontratave të reja.** Për këto raste konstatojmë vonesa në lidhjen e kontratave, mos transferim të kontratave për objektet që figurojnë debitorë. Nga ana jonë është udhëzuar të bëhet lidhja e kontratave për të gjithë ata subjekte që nuk janë debitorë, udhezim i cili nuk është marrë parasysh nga ana e kompanisë.

**Fenomeni i moskreditimit të abonentëve.** Vazhdon të ndihet fenomeni i moskreditimit të abonentëve që megjithëse kanë kryer të gjitha pagesat e konsumit të energjisë, rezultojnë debitorë. Ky ka bërë që shumë konsumatorë të përballen me ndërprerjen e padrejtë të energjisë elektrike. Nga dokumentacioni që kemi shqyrtuar, kemi konstatuar se kemi të bëjmë me raste ku konsumatorët i kanë kryer pagesat kryesisht me bankë ose postë dhe në këto raste vërejmë mos rakordimin e faturave të paguara, por kemi edhe raste të kryerjes se pagesave në zyrat e shitjes dhe për të cilat mungon dokumentacioni i kryerjes së këtyre pagesave. Procedura e ndjekur për këta konsumatorë, ka qenë kryerja e verifikimit në vend të Librezës origjinale apo pagesat e kryera ne Arkë apo Bankë, me Sistemin e Billingut të “OSHEE”sh.a, duke bërë me pas sistemimet e nevojshme .

**Trajtimi i ankesave nga ana e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit të “OSHEE” sha.** ERE ka monitoruar dhe konstatuar se, trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ana e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit të “OSHEE” sha, ka ende probleme të theksuara, ku me tipike vijon të jetë mos dhënia përgjigje brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren e Trajtimit të Ankesave”. Mungesa e dhënies së përgjigjes apo zgjidhjes në kohën e përcaktuar nga Rregullorja nga ana e kompanisë “OSHEE”sh.a, ka bërë që konsumatorët, në pjesën më të madhe të tyre, të paraqiten në ERE pas kalimit të afatit të kthimit të përgjigjes nga ana e OSHEE-se për zgjidhjen e ankesës. Në tabelën në vijim paraqitet situata e ankesave të konsumatorëve gjatë vitit 2014.

**Tabela 7-3** Analiza mbi ankesat/kerkesat e ardhura nga ERE, Av. Popullit dhe HO gjate 2014 sipas statusit dhe muajve

Zona	Lloji i përgjigjes	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Av.Popullit	Ne proces	3	2				1	4	1	5	9	12	8	45
	Te refuzuara		1				1							2
	Te zgjidhura	10	14	12	12	8	15	16	9	5	16	9	1	127
<b>Av.Popullit Total</b>		13	17	12	12	8	17	20	10	10	25	21	9	174
ERE	Ne proces		50	44	70	47	50	63	16	91	119	168	201	919
	Te refuzuara		6	9	6	2						1		24
	Te zgjidhura	4	159	123	150	52	128	111	12	95	47	58	41	980
<b>ERE Total</b>		4	215	176	226	101	178	174	28	186	166	227	242	1,923
Zyrat Qendrore	Te perfunduara										1			1
	Ne proces	48	111	76	141	159	168	154	114	280	232	559	422	2,464
	Te refuzuara	3	11	5	7	8	7	7	1	3	4	11	1	68
	Te zgjidhura	119	302	185	303	242	225	227	166	148	174	194	146	2,431
<b>HO Total</b>		170	424	266	451	409	405	388	281	431	411	764	569	4,964
<b>Total</b>		187	656	454	689	518	595	582	319	627	602	1,012	820	7,061

**Tabela 7-4** Analiza mbi statusin e ankesave dhe kerkesave te marra sipas muajve gjate 2014

Tipi	Ankesa					Kerkesa					Total
	Te mbyllura	Ne proces	Te refuzuara	Te zgjidhura	Total	Te mbyllura	Ne proces	Te refuzuara	Te zgjidhura	Total	
Janar	101	918	73	4,036	5,128		997	86	6,187	7,270	12,398
Shkurt	94	950	99	3,872	5,015		874	77	5,480	6,431	11,446
Mars	83	1,012	77	3,721	4,893		848	67	5,273	6,188	11,081
Prill	108	1,266	101	3,418	4,893		1,112	59	5,732	6,903	11,796
Maj	152	2,878	160	3,652	6,842		861	53	4,599	5,513	12,355
Qershor	112	2,715	96	2,985	5,908		1,048	41	4,347	5,436	11,344
Korrik	67	2,025	68	2,502	4,662		1,226	28	4,196	5,450	10,112
Gusht	47	1,713	60	2,390	4,210	1	1,593	57	4,710	6,361	10,571
Shtator	68	1,952	56	2,469	4,545		1,863	31	4,620	6,514	11,059



Tetor	47	2,012	46	2,789	4,894	1	3,411	45	4,649	8,106	13,000
Nentor	57	2,637	32	4,083	6,809		7,919	45	7,104	15,068	21,877
Dhjetor	3	2,982	16	3,965	6,966		6,165	18	7,207	13,390	20,356
Total	939	23,060	884	39,882	64,765	2	27,917	607	64,104	92,630	157,395

**Tabela 7-5** Analiza mbi ankesat/kerkesat per vitin 2014 sipas zonave dhe statusit te tyre

Zona	Të Mbyllura			Në proces			Të refuzuara			Të zgjidhura			Total
	Ankesa	Kerkesa	Total	Ankesa	Kerkesa	Total	Ankese	Kerkesa	Total	Ankesa	Kerkesa	Total	
Berat	40		40	2,074	1,141	3,215	102	27	129	2,831	3,289	6,120	9,504
Burrel	76		76	1,085	522	1,607	14	2	16	1,150	1,671	2,821	4,520
Durres				3,254	3,098	6,352	114	160	274	4,608	7,253	11,861	18,487
Elbasan	57		57	2,513	2,118	4,631	65	32	97	3,681	4,362	8,043	12,828
Fier	133		133	2,348	2,829	5,177	56	14	70	5,365	6,044	11,409	16,789
Gjirokastr	47		47	1,951	2,227	4,178	68	4	72	2,074	2,680	4,754	9,051
Korce	61	1	62	890	770	1,660	172	157	329	2,811	5,160	7,971	10,022
Kukes				28	200	228	3	1	4	118	392	510	742
Shkoder	19		19	901	2,761	3,662	83	102	185	2,617	3,422	6,039	9,905
Tirane	506		506	5,391	11,448	16,839	138	83	221	12,276	28,644	40,920	58,486
HO		1	1	1,726	738	2,464	44	24	68	1,299	1,132	2,431	4,964
ERE				863	56	919	23	1	24	937	43	980	1,923
Av.Popullit				36	9	45	2		2	115	12	127	174
Total	939	2	941	23,060	27,917	50,977	884	607	1,491	39,882	64,104	103,986	157,395

Për informimin e palëve të treta ka funksionuar aksesimi në rrjet dhe komunikimin nëpërmjet faqes së Web-it, duke ofruar një pasqyrë më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Kjo faqe siguron aksesin dhe plotësimin online të formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit, informacioni i përditësuar mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, kushtet e licencimit, të gjitha vendimmarrjet e ERE, regjistrimin e të licencuarve, informacion të detajuar mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Faqja e web-it në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, është përditësuar nëpërmjet “broshurës së konsumatorit”.

**Marrëdhëniet me Publikun, Median e Shkruar dhe Vizive.** ERE i ka dhënë një rëndësi dhe prioritet të vecantë komunikimit me publikun e gjerë. Për të garantuar një komunikim sa më transparent dhe të drejtëpërdrejtë janë realizuar disa deklaratat dhe njoftime për shtyp, komunikime intensive përmes mediave, publikime të informacioneve që kanë të bëjnë me nivelin e shërbimeve nga pjesëmarrësit në sektorin e energjisë, dhe seanca dhe mbledhje publike. Komunikimi është realizuar nëpërmjet dhënies së informacionit përmes intervistave të shumta televizive, gazeta dhe revista, mbajtjes sistematike në kontakt nga drejtues të ERE, dhe vënies në dispozicion të të dhënave të kërkuara nga gazetarët që mbulojnë sektorin energjetik, në respekt kjo të ligjit për të drejtën e informimit. Theksojmë faktin se, ERE i është përgjigjur pozitivisht dhe në kohë kërkesave të vazhdueshme të medias për sqarime rreth çështjeve të ndryshme, sidomos ndaj problematikave të kompanisë

“OSHEE”sh.a, por edhe ndaj zhvillimeve të projektit TAP. Miratimi i çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015, ka patur një ndjesi dhe reagim, të medias në kohë të shpejtë, kurse drejtuesit e institucionit kanë respektuar median për kërkesat e tyre në ofrimin e informacioneve të ndryshme.

**Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.** Komunikimi i ERE-s me pjesëtarët e tjerë të tregut ka qenë aktiv. Kjo duke u mbështetur në zbatimin e përgjegjësive dhe detyrimeve që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë, me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, konsumatorëve dhe investitorëve. Në këto kushte ERE, ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë. Ky bashkëpunim kryesisht është realizuar nëpërmjet konsultimeve dhe takimeve me operatorët e tregut të energjisë elektrike. Përpunimi dhe dhënia në kohë e informacionit të kërkuar nga subjektet, ka qenë një formë tjetër e komunikimit mes ERE-s dhe subjekteve të interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij.

**Seancat Dëgjimore.** Duke mbajtur në konsideratë parimet e ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe personave privatë, parimin e paanësise dhe bashkëpunimit për një gjykim të drejtë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes të licensuarve dhe zgjidhjen e ankeave të konsumatorëve gjithashtu dhe në procesin e hartimit të akteve nënligjore, ERE organizon seancat dëgjimore. Mbeshtetur dhe në parimin e transparencës së saj ERE, bazuar në “Rregulloren e Praktikës dhe Proçedurave”, ka organizuar një sërë seancash dëgjimore. Rreth 53 seanca dëgjimore janë zhvilluar për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave, duke bërë një grupim të problematikave të hasura. Në qëllim të tyre këto seanca kanë patur ballafaqimin i shqetësimeve të gjithë aktorëve të tregut, dhe konsumatorëve të energjisë. Në këtë kuadër janë dhënë udhëzime dhe rekomandime nga ana e ERE-s, të cilat janë të detyrueshme për pjesëmarrësit e tregut, për zgjidhjen e problemeve të konstatuara me konsumatorët apo në mosmarrëveshjet ndërmjet të licensuarve dhe aktoreve të tjere të tregut të energjisë elektrike.

Janë organizuar gjithashtu seanca dëgjimore me aktorë kryesorë të tregut të energjisë të tillë si “KESH”, “OST” dhe “OSHEE”, të cilat kanë patur për objekt konsultimet për aktet rregullatore apo trajtimin e problematikave të ndryshme, të tilla si: diskutime në lidhje me kontratën tip, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që kanë subjektet ndaj njeri-tjetrit dhe realizimi i një skedulimi të pagesave etj.

Rreth 26 seanca dëgjimore kanë patur si subjekte konsumatorë të energjisë elektrike kryesisht konsumatorë familjarë, jofamiljarë dhe insitucione shtetërore (Shkolla, Ministria e Punëve të Brendshme; Prokuroria e Përgjithshme etj), të cilët janë ankuar kryesisht për mbifaturime, për faturimet në ambientet e përbashkëta; faturim të parregullt; faturimet e konsumatorëve me anomalji; kontratat fiktive etj.

Lidhur me këto seanca ERE, në zbatim të një procedurë transparente, duke evidentuar dhe analizuar problematikat e vërejtura iu ka bërë të ditur të interesuarve qëndrimin e saj duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse.

**Treguesit e cilesise se sherbimit.** Këto jepen në tabelën 7-6.

**Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.** Komunikimi online nëpërmjet faqes zyrtare të Web-it të ERE-s, është zhvilluar duke ofruar një pasqyrë sa më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. ERE kryen azhurnimin sistematik të faqes së Internetit duke u ofruar të gjithë të interesuarve një informacion të përditësuar mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE, regjistrin e të licensuarëve, kushtet e licencimit, informacion të detajuar mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Faqja web-it të ERE-s gjatë vitit 2014 ka vazhduar të ofrojë informacione mbi mbledhjet e Bordit të Komisionerëve, vendimet përkatëse si dhe për veprimtaritë e ERE-s në nivel kombëtar dhe rajonal.

Tabela 7-6 Treguesit e cilësisë së shërbimit

TREGUESIT E CILËSISË SE VAZHUESHMERISË SE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE 2014																																				
TL	SHKAKU I NDERPRERJES				NUMRI I Konsumatoreve të lidhur			Nderprerje të Planifikuara					Nderprerje të Pa Planifikuara				SAIFI	SAIDI	CAIDI																	
	Nderprerje e Planifikuuar	Forcë Mëdhorë	Pergjegjësi e paleve të treta	Pergjegjësi e CEZ	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RURALE	Nr. Konsumatoreve të prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. Konsumatoreve të prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. i konsumatoreve të prekur nga nderprerjet/Nr. Kons.Gjithesj	Nr. i orëve të nderprerjeve gjthesh/Nr. Konsumatoreve Gjithesj	Nr. i orëve të nderprerjeve gjthesh /Nr. Kons. Te prekur nga nderprerjet																
Janar	39	5	13	116	1,163,467	589,633	573,834	61,776	11,969	49,806	141,011	90	801,060	235,697	565,363	2,314,704	502	0.74	2.11	2.85																
Shkurt	59	3	17	88	1,163,467	589,633	573,834	141,564	30,737	110,827	587,453	126	636,043	202,990	433,053	1,613,356	327	0.67	1.89	2.83																
Mars	80	10	16	72	1,163,467	589,633	573,834	288,282	76,264	212,018	791,304	192	504,109	136,931	367,178	1,401,990	353	0.68	1.89	2.77																
Prill	116	3	18	84	1,163,467	589,633	573,834	451,095	165,110	285,985	1,419,399	349	679,107	199,318	479,790	1,725,262	414	0.97	2.70	2.78																
Maj	103	11	42	73	1,163,467	589,633	573,834	425,281	140,467	284,814	1,158,097	279	938,640	186,559	752,091	4,234,321	631	1.17	4.63	3.95																
Qershor	101	30	33	93	1,163,467	589,633	573,834	402,176	177,730	224,446	1,011,500	252	760,342	174,504	1,358,838	3,571,067	715	1.00	3.94	3.94																
Korrik	73	25	1	112	1,163,467	589,633	573,834	258,909	80,081	178,828	776,947	178	713,870	172,833	541,037	2,596,291	602	0.84	2.90	3.47																
Gusht	47	13	32	91	1,163,467	589,633	573,834	157,845	50,742	107,103	332,236	106	773,574	228,001	545,573	1,369,932	433	0.80	1.46	1.83																
Shtator	78	25	45	124	1,163,467	589,633	573,834	352,285	72,420	279,865	996,183	216	993,324	303,042	690,282	2,952,936	869	1.16	3.39	2.93																
Tetor	84	10	49	62	1,163,467	589,633	573,834	1,151,826	98,047	262,779	771,409	242	803,845	232,864	454,536	2,997,923	740	1.68	3.23	1.92																
Nentor	65	29	52	99	1,163,467	589,633	573,834	345,421	111,384	233,837	907,295	164	1,062,436	334,624	727,812	2,559,633	466	1.21	2.97	2.46																
Dhjetor	30	31	36	185	1,163,467	589,633	573,834	1,302,267	334,077	968,190	3,260,873	902	135,945	87,641	55,204	357,845	66	1.23	3.11	2.51																
TM	SHKAKU I NDERPRERJES				NUMRI I Konsumatoreve të lidhur			Nderprerje të Planifikuara					Nderprerje të Pa Planifikuara				SAIFI	SAIDI	CAIDI																	
	Nderprerje e Planifikuuar	Forcë Mëdhorë	Pergjegjësi e paleve të treta	Pergjegjësi e CEZ	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RURALE	Nr. Konsumatoreve të prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. Konsumatoreve të prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve të prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. i konsumatoreve të prekur nga nderprerjet/Nr. Kons.Gjithesj	Nr. i orëve të nderprerjeve gjthesh/Nr. Konsumatoreve Gjithesj	Nr. i orëve të nderprerjeve gjthesh /Nr. Kons. Te prekur nga nderprerjet																
Janar	104	58	10	2,343	1,163,467	589,633	573,834	143,513	22,821	120,692	368,322	271	3,316,105	758,561	2,557,540	5,988,797	6,564	2.97	5.46	1.84																
Shkurt	110	39	3	1,957	1,163,467	589,633	573,834	141,019	41,586	99,133	322,300	254	2,613,064	445,689	2,167,375	4,024,048	4,733	2.37	3.74	1.58																
Mars	145	145	3	2,387	1,163,467	589,633	573,834	1,359,824	265,379	1,094,445	419,938	384	3,335,276	600,876	2,733,573	5,171,098	14,109	4.04	4.81	1.19																
Prill	239	66	1	2,613	1,163,467	589,633	573,834	278,940	71,624	207,506	835,351	722	3,413,139	633,937	2,780,042	6,452,729	9,443	3.17	6.26	1.97																
Maj	262	79	4	2,387	1,163,467	589,633	573,834	309,540	42,475	267,065	881,522	761	3,203,884	731,290	2,472,594	5,422,073	5,632	3.02	5.42	1.79																
Qershor	315	217	1	3,003	1,163,467	589,633	573,834	377,675	46,964	327,545	1,138,615	955	3,778,500	624,917	3,145,764	6,425,800	7,533	3.57	6.49	1.82																
Korrik	197	242	14	2,682	1,163,467	589,633	573,834	209,234	41,646	166,911	572,421	585	3,589,222	541,218	5,176,515	6,192,075	7,743	3.26	5.81	1.78																
Gusht	275	147	7	2,001	1,163,467	589,633	573,834	314,527	47,809	266,618	896,271	836	2,629,918	485,005	2,144,884	3,766,568	5,599	2.53	4.01	1.58																
Shtator	214	188	2	3,502	1,163,467	589,633	573,834	215,909	39,863	169,816	496,580	541	4,445,444	752,906	3,697,853	10,896,814	11,985	4.01	9.79	2.44																
Tetor	318	100	1	2,754	1,163,467	589,633	573,834	401,974	104,766	297,208	193,676	1,017	3,517,727	617,158	2,901,742	6,271,356	9,727	3.36	6.41	1.90																
Nentor	133	110	13	2,746	1,163,467	589,633	573,834	124,064	11,336	112,728	377,225	447	3,602,732	786,392	2,816,340	7,632,432	8,347	3.20	6.88	2.14																
Dhjetor	156	70	4	3,866	1,163,467	589,633	573,834	206,388	32,834	173,554	644,174	500	4,668,751	986,934	3,681,817	13,863,758	20,853	4.19	12.46	2.97																

Gjithashtu gjatë vitit 2014 në faqen zyrtare të ERE-s kanë filluar të përkthehen në gjuhën Angleze dhe publikohen të gjitha vendimet e Bordit si dhe çdo informacion tjetër, i cili lidhet me veprimtarinë e ERE-s. Gjithashtu në faqen zyrtare vazhdon të sigurohet aksesimi dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit.

### 7.3 Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s

Një rëndësi të veçantë edhe gjatë vitit 2014 iu kushtua marrëdhënieve ndërinstitucionale brenda vendit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare multilaterale dhe

bilaterale. Për vitin 2014 nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë është punuar shumë që ERE të përfaqësohet denjësisht në arenën ndërkombëtare dhe në forcimin e rolit të saj pranë institucioneve ku ajo aderon.

Kryesisht ERE ka ndarë informacione dhe qëndrime me Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrinë e Integritit, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, si dhe institucione të tjera të cilat operojnë në Republikën e Shqipërisë veprimtaria e të cilëve lidhet në një masë të caktuar me çështje të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

### **7.3.1 Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë**

Për vitin 2014 ERE sikurse dhe më parë ka vazhduar të ndjekë në mënyrë korrekte dhe intensive bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke informuar periodikisht dhe pasqyruar hap pas hapi veprimtarinë institucionale në zbatim të vendimit të Byrosë së Kuvendit Nr. 29, datë 09.02.2008 “Për ngritjen e Shërbimit të Monitorimit të institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin”. Në kuadër të këtij vendimi punonjësi i autorizuar përgjegjës për kryerjen e këtij shërbimi ka ndjekur nga afër dhe është njohur në mënyrë të detajuar me veprimtarinë e ERE-s, si dhe ka asistuar here pas here në mbledhjet e Bordit të Komisionerëve.

Kontaktet kanë konsistuar në lidhje me: “Vlerësimin e Veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2013” dhe në zbatimin e kërkesave dhe sugjerimeve që janë bërë nga ana e Kuvendit për Vitin 2014, referencat për Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, riemërimet dhe emërimet e reja të zyrtarëve si dhe të dhënat ekonomike të EREs.

Nga ana e tij Kuvendi është informuar me zhvillimet aktuale në Sektorin e Energjisë, ku përveç se është bërë paraqitja e Raportit Vjetor në Kuvend, ERE ka dërguar informacion të çështjeve të mprehta që kishin të bënin me Tregun e Energjisë. Gjithashtu ka vijuar edhe gjatë këtij viti dhënia e informacioneve të kërkuara nga Deputetë të Kuvendit.

### **7.3.2 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI)**

Gjatë vitit 2014 ERE ka bashkëpunuar dhe bashkërenduar një pjesë të punës së saj me MEI-n për zgjidhjen e shumë problemeve dhe sfidave të ndryshme të ndeshura gjatë procesit të rregullimit të sektorit të energjisë në Shqipëri.

ERE ka kontribuar qoftë përmes propozimeve të dala prej saj apo përmes dhënies së opinionëve të ndryshme të propozuara, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në Grupet ndërinstitucionale të Punës për rishikimin e Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (Direktiva e 3-t), të Ligjit të Energjive të Rinovueshme dhe projektet e ardhshme në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Gazit.

ERE ka zhvilluar nje komunikim intensiv me MEI-së në lidhjen me hapat që duhet të ndiqeshin në procesin e shpronësimit të asetëve të kompanisë CEZ Shpërndarje dhe kalimin e tyre në pronësi të shtetit Shqiptar. Gjithashtu gjatë vitit 2014 ka bashëpunuar me MEI mbi problematikën e sektorit, perspektivën e tregut të energjisë elektrike dhe format e bashkëpunimit me fokus statusin në treg të prodhuesve të Vegjel të Energjisë.

ERE do të vazhdojë ta vlerësojë dhe do ta ketë një ndër përparësitë e saj bashkëpunimin me MEI-së.

### **7.3.3 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritit**

Për vitin 2014 ERE ka vijur komunikim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Integritit në lidhje me Komitetin e Stabilizim Asociimit, për përditësimin e informacioneve në lidhje me Planin kombëtar, për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për periudhën 2010-2014. Në kuadër të kësaj ERE ka rishikuar aktet e parashikuara në PKZMSA dhe ka kontribuar për plotësimin e kërkesave që vijnë nga Direktivat e BE-së. Këto kërkesa vijnë si rrjedhojë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe për plotësimin e Direktivës 54/2003. Gjithashtu gjatë këtij viti ERE ka bashkëpunuar me Ministrinë e Integritit në lidhje me Raportimin Vijues në kuadër të Nënkomitetit Transporti, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal. ERE ka kryer raportim të rregullt për grupet e raportimit (Peer review mission) të Bashkimit Europian të cilat janë parqitur pranë ERE-s, gjithashtu ka kryer raportimin vjetor në bashkëpunim me Ministrin e Integritit pranë BE-s në Bruksel.

### **7.3.4 Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës**

ERE i ka bazuar marrëdhëniet e saj me institucionin e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet ERE-s dhe Autoritetit të Konkurrencës që prej datës 17.01.2007.

Përgjatë vitit 2014 është bashkëpunuar ndërmjet dy institucioneve për shmangien e shkeljes së konkurrencës nga ana e operatorëve, në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve. Ky bashkëpunim ka konsistuar në çështje mjaft të rëndësishme përgjatë vitit 2014, siç ka qenë ajo e tarifave të Energjisë Elektrike, rekomandime për rritjen e konkurrencës në Tregun e Prokurimit të Energjisë Elektrike për mbulimin e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes, në lidhje me Rregulloren e “Rregullave të Ankandit”.

Gjithashtu, ERE ka organizuar takime apo seanca dëgjimore në kuadër të rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe i të dhënave ndërmjet të dy institucioneve do të vijojnë edhe në të ardhmen duke konsideruar edhe nevojën për

përpunimin e akteve nënligjor në kuadër të daljes së ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

### **7.3.5 Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit**

Një ndër prioritetet e marrëdhënieve të ERE-s është edhe ajo me Avokatin e Popullit, ku të dy institucionet kanë një angazhim të përbashkët institucional për mbrojtjen e konsumatorëve fundorë të energjisë elektrike në përputhje me përgjegjësitë që respektivisht kanë sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve. Në kuadër të këtij angazhimi, edhe gjatë vitit 2014 ERE ka mbajtur marrëdhënie të afërta institucionale me Avokatin e Popullit duke realizuar disa takime të përbashkëta në drejtim të shkëmbimit të mendimeve, por edhe në rastet kur janë kërkuar sqarimeve të nevojshme në lidhje me cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve. Gjithashtu janë diskutur dhe ankesat në lidhje me faturat e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve fundorë.

## **7.4 Marrëdhëniet Ndërkombëtare**

Është prioritet i ERE-s përfaqësimi sa më dinjitoz i vendit dhe Rregullatorit në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të BE-së. Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Kjo është një ndër arsye për të cilat mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERE-s në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, në organizimin e konferencave ndërkombëtare, në bashkëpunimin me institucionet e tjera për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare, workshopeve apo takimeve multilaterale dhe bilaterale.

Për vitin 2014 ERE ka punuar me një intensitet të lartë për realizimin e bashkëpunimeve sa me frytdhënëse në dobi të sektorit energjetik të vendit. Duke vendosur këto prioritetet, ERE ka punuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si ERRA, MEDREG, USAID, NARUC, ECRB, Sekretariati i Energjisë Vjenë etj. Nga ana tjetër, ERE ka mbajtur marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera rregullatore si motra, duke realizuar takime të përbashkëta dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare të lidhura me energjinë.

### 7.4.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare e ERRA-s

ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA). Ajo realizon një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve, si dhe të Grupit të Punës mbi çështjet ligjore që zhvillohen në vendet anëtare të ERRA-s.

ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike. Stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës për energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, të Grupit të Punës së Energjisë elektrike, si dhe në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të saj. Gjithashtu ERE në mars të 2014 ka organizuar në Tiranë mbledhjen e radhës së komitetit drejtues të MEDREG. Kjo shoqatë e mbështetur nga Komisioni Europian është një mundësi e vlefshme në drejtim të njohjes së mundësive, harmonizimit të kuadrit rregullator dhe potencialeve energjetike të vendeve të Mesdheut. Por, në të njëjten kohë jep mundësinë e vendosjes së një klime mirëkuptimi dhe bashkëpunimi të rregullatorëve të këtyre vendeve për çështje të ndryshme të interesit ndërmjet tyre. Gjatë Asamblesë së Përgjithshme të organizuar në nëntor 2014, Kryetari i ERE-s Zoti Petrit Ahmeti, u zgjodh zëvendës president i Rregullatorëve të Mesdheut me një mandat dy vjeçar. Gjithashtu Komisioneri Z. Maksim Shuli u emërua nën kryetar i grupit të punës së Gazit të MEDREG. Kjo tregon angazhimin e ERE-s në arenën ndërkombëtare dhe siguron një përfaqësim sa më dinjitoz të vendit.

Për vitin 2014, ERE ka mbajtur një bashkëpunim të frytshëm me USAID në projektin e përbashkët afatgjatë të përkrahur nga vetë USAID, ku janë përfshirë përfaqësuesit e rregullatorëve të rajonit dhe kompanitë e sistemit të shpërndarjes të rajonit. Ndër projektet kryesore që ERE ka marrë pjesë është ai i bashkëpunimit dhe koordinimit të operatorëve të shpërndarjes së ballkanit dhe projekti i detit të zi. Projekti i parë ka sjellë rezultate pozitive në koordinimin e Operatorëve të Shpërndarjes së Ballkanit.

ERE, në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, gjatë vitit 2014 ka marrë pjesë aktive në Forumet e Energjisë në Athinë, Forumin e Gazit në Lubjanë dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë, të organizuara nga Sekretariati i Vjenës. Gjithashtu ERE ka qenë shumë aktive në bashkëpunimin me Sekretariatit të Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Nga ana tjetër, shumë draft-vendime të ERE-s janë konsultuar me Sekretariatit të Vjenës. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, si dhe gazit natyror. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit për sa i përket një zgjidhjeje sa më të mirë të problemit me CEZ, për realizimin e një tregu të përbashkët me Kosovën, për Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve dhe për projektin TAP. Vlen të theksohet që ERE ka marrë pjesë dhe në trajnimet dhe workshopet e organizuara nga ana e Sekretariatit për cilësinë e



shërbimit, sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e konsumatorit, paketën e tretë legislative dhe modelet e tregut të energjisë dhe gazit natyror. Përfaqësuesit e Sekretariatit të Vjenës e kanë përkrahur në mënyrë aktive ERE-n për zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë vitit 2014.

Institucioni ynë është munduar të përfitojë sa më shumë nga këto aktivitete dhe nga eksperiencia e Rregullatorëve të bashkimit Evropian, për harmonizimin e legjislacionit, praktikave dhe procedurave me qëllim krijimin e një tregu të përbashkët rajonal të energjisë, transparent, konkurses, jo diskriminues dhe me akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

#### **7.4.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s**

Marrëdhëniet bilaterale të ERE-s për vitin 2014 kanë pasur si qëllim të forcojnë kapacitetin institucional të saj dhe vendosjen e bashkëpunimeve sa më të suksesshme në dobi dhe përmirësim të sektorit energjetik të vendit. ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marrëveshjet bilaterale, ku mund të përmendim takimet të ndërsjellta me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për tarifatat, legjislacionin dhe çështjen e tregut të përbashkët.

Për thellimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe koordinimin mes tyre, ERE ka organizuar dhe takime me Rregullatorin Malazez për të diskutuar mbi projektet e përbashkëta, metodologjinë e tarifave dhe projektin e gazesjellësit TAP.

